FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 64 Gusht 2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.172, datë 19.2.2009	Për miratimin e dokumentit të politikave dhe të planit të veprimeve, për përmirësimin e raportimit financiar në Shqipëri	3

VENDIM
Nr.172, datë 19.2.2009

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE DHE TË PLANIT TË VEPRIMEVE, PËR PËRMIRËSIMIN E RAPORTIMIT FINANCIAR NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të politikave dhe të planit të veprimeve, për përmirësimin e raportimit financiar në Shqipëri, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe institucionet publike, të përfshira, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKE E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE
MINISTRIA E FINANCAVE
Komiteti Kombetar i Drejtimit

Dokumenti i politikave dhe Plani i Veprimeve

për

Përmirësimin e Raportimit Financiar në Shqipëri.

SHKURTIME

K&A	Kontabilitet dhe Auditim
BCBS	Komisioni i Basel për Mbikqyrjen Bankare
CEBS	Komisoni i Mbikqyrësve Bankarë Europianë
CEIOPS	Komisioni i Mbikqyrësve Europianë të Sigurimeve dhe Pensioneve të Punës
CESRfin	Komisioni i Rregullatorëve Europianë të Letrave me Vlerë – Grupi Operacional për Raportimin Financiar
CPD	Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional
BE	Bashkimi Europian
FBE	Federata Europiane Bankare
FEE	Federata Europiane e Kontabilistëve
GDLN	Rrjeti i Zhvillimit Global të Dijes
IAASB	Këshilli i Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurimit
IAIS	Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve
IAPC	Komisioni Ndërkombëtar i Praktikave të Auditimit
IAPS	Deklarate e Praktikës Ndërlkombëtare të Auditimit
IAS (SNK)	Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
IASB	Këshilli i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit
IASC	Komisioni i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit
IASCF	Fondacioni i Komisionit të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë
IES	Standartet Ndërkombëtare të Arsimit
IFAC	Federata Ndërkombëtar e Kontabilistëve
IFRIC	Këshilli Ndërkombëtar Interpretues i Raportimit Financiar
IFRS (SNRF)	Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IOSCO	Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë
ISA (SNA)	Standartet Ndërkombëtare për Auditimin
MF	Ministria e Financave
SKK	Standarte Kombëtare të Kontabilitetit
KKD	Këshilli Kombëtar Drejtues
QA	Garantimi i Cilësise
REPARIS	Rruga për në Europë – Programi I Reforms së Kontabilitetit dhe Forcimit Institucional
ROSC	Raport I Vezhgimit të Standarteve dhe Kodeve
SCE	CESRfin Nën-Komision për Zbatimin
SEEPAD	Partneriteti I Europës JugLindore për Zhvillimin e Kontabilitetit
SIC	Komisioni i Përhershëm i Interpretimit
SISE	CESRfin Nën-Komision për Miratimin e Standarteve Ndërkombëtare
SMEs	Sipërmarrjet e Vogla dhe Të Mesme
SMOs	Deklarata e Detyrimeve të Anëtarësimit
XBRL	Gjuha e Zgjeruar e Raportimit të Biznesit

1 PËRMBLEDHJE

1.1 Hyrje

Ky studim paraqet nje dokument politikash dhe planin e veprimit për të rritur cilësinë e raportimit financiar të korporatës në Shqipëri. Dokumenti i politikave u përgatit nga Komiteti Kombëtar Drejtues (KKD) i përbërë nga pjesëmarrës të sektorit publik dhe privat të interesuar për raportimin financiar të korporatës, komitet i cili u krijua në vitin 2007. Ky dokument politikash dhe plan veprimi per vendin paraqet nje program reformash për te përmirësuar kuadrin ligjor, institucionet, dhe profesionin e kontabilistit ne Shqipëri, si edhe kulturën e Shqipërise per kontabilitetin, auditimin dhe biznesin, me qëllim kryerjen e raportimit financiar me cilësi të lartë.

1.2 Përfitimet e përmirësimit të raportimit financiar të korporatave

Përmirësimi i raportimit financiar të korportës nuk duhet të konsiderohet si një objektiv në vetvete: është shumë më tepër se kaq. Raportimi finaciar me cilësi të lartë është themeli i një ekonomie tregu që funksionon mirë dhe baza e një sistemi të fortë financiar. Përmirësimi i raportimit financiar në Shqipëri do të ketë një impakt të ndjeshëm dhe pozitiv në ekonomi duke:

- Reduktuar rrezikun për kriza në tregun financiar dhe impakteve negative ekonomike që sjellin ato nëprmjet forcimit të strukturës financiare vendase;
- Kontribuar në investimet e huaja direkte dhe të portofolit dhe duke ndihmuar në shfrytezimin e kursimeve vendase;
- Lehtësuar aksesin e korporatave të vogla huamarrëse për kredi nga sektori finaciar formal nëpërmjet zvogëlimit te kostove te larta të informacionit dhe huamarrjes;
- Lejuar investitorët të bëjnë vlerësimet e duhura të perspektivave të korporatave dhe për të marrë vendime të informuara për investimet dhe votimet, të cilat rezultojnë në një kosto më të ulët të kapitalit dhe në një alokim më të mirë të burimeve;
- Lejuar aksionerët dhe publikun e gjerë të vlerësojë performancën e menaxhimit të një kompanie, pra duke nxitur zhvillimin aktiv te tregjeve kapitale; dhe
- Mbështetur integrimin ekonomik, rajonal dhe global.

1.3 Faktorët ndikues për përmirësimin e raportimit financiar të korporatës në Shqipëri

KKD konfirmoi se raportimi i mirë financiar i korporatës varet nga adoptimi dhe aplikimi i disa pikave referimi, standarteve, kodeve dhe praktikave të ndryshme. Sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), dhe praktikave të mira ndërkombëtare, pika kryesore referuese është *acquis*

communautaire[1] që ka të bëjë me ligjin për kompanitë, raportimin financiar, auditimin, tregjet financiare, dhe institucionet financiare. Transpozimi dhe implementimi i duhur i *acquis communautaire* është bërë edhe më i rëndësishmëm pasi Bashkimi Europian (BE) më 12 Qershor 2006 ka nënshkruar Marveshjen e Stabilizim Asocimit.

KKD mori parasysh eksperiencën e Shteteve Anëtare të BE-së duke pranuar se një dokument politikash te suksesshme për vendin duhet të adresojë si çështjet ligjore dhe ato institucionale. Vetëm detyrimi për raportim të përmirësuar financiar të korporatës nuk është i mjaftueshëm. Kuadri i përmirësuar ligjor duhet gjithashtu të zbatohet dhe imponohet nga institucionet e pajisura me burimet e përshtatshme. Dokumenti i politikave dhe plani i veprimit të vendit identifikon veprimet që lidhen me këto dy shtylla kryesore: kuadri ligjor dhe kuadri institucional.

KKD ka parasysh kapacitetin e Shqipërisë për të realizuar aktivitetet e propozuara. Në disa raste, një rregull relativisht i butë i cili imponohet fuqishëm dhe në mënyrë konsistente është më i preferuar se një rregull i fortë i cili është i paimponueshëm, pasi rregulli i butë mund të forcohet në mënyrë progresive sipas rrethanave. Si rezultat, KKD ka vendosur të hartojë reformat të cilat, megjithëse konsiderohen një sfidë e vështirë, mund të realizohen në një periudhë afatshkurtër deri afat-mesme.

KKD ka patur gjithashtu parasysh raportin e Bankës Botërore të vitit 2006, Vëzhgimi i Standarteve dhe Kodeve (ROSC[2]) për kontabilitetin dhe auditimin në Shqipëri. Banka Botërore, Ministria e Financave dhe grupet vendase të interesit ranë dakord mbi rekomandimet e politikës së ROSC dhe formuan në këtë mënyrë një platformë të rëndësishmë për zhvillimin e një strategjie dhe plan veprimi të vendit.

1.4 Dokumenti i politikave për të arritur raportim të përmirësuar financiar të korporatës

Përfitimet prej raportimit të përmirësuar financiar të korporatës janë domethënëse. Masat që kërkohen për të arritur këto përfitime janë gjithashtu te konsiderueshme. KKD ka identifikuar një numër shtyllash kyçe që përbëjnë bazën për strategjinë vendase që duhet të realizohet sipas nën aktiviteteve të përcaktuara në plan.

---

1 Tërësia e të gjitha ligjeve të Bashkimit Europian Union njihet si *acquis communautaire*. Termi përdoret më shpesh në lidhje me përgatitjen nga vendet kanditate për të hyrë në Bashkimin Europian. Me qëllim që këto vende të lejohen të hyjnë në Bashkimin Europian, ato duhet të adoptojnë, zbatojnë dhe imponojnë të gjitha pjesët e *acquis*. *Acquis communautaire* përfshin të gjithë legjislacion primar (aktet), legjislacionin sekondar (Rregullore, Direktiva etj.) dhe jurispudenca/precedenti (gjykimet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë Gjykatës Europiane së Shkallës së Parë).

2 Për raporin e plotë ROSC shiko Shtojce A.

1) Shtylla Kryesore 1: Përmirësimi i Kuadrit Institucional;

2) Shtylla Kryesore 2: Konsolidimi i Kapacitetit Institucional;

3) Shtylla Kryesore 3: Rritja e Ndërgjegjësimit mbi Raportimin Financiar dhe Auditimin Statutor.



Figura 1-1: Dokument politikash & Plani i Veprimit të Vendit

Aktivitetet specifike brenda secilës shtyllë kryesore, për të arritur këto objektiva të larta, janë paraqitur në Kapitullin 4. Për të vendosur për veprimet (masat) specifike, KKD kreu një studim të sistemit aktual të raportimit financiar të korporatave në Shqipëri. Ky studim u realizua nëpërmjet intervistave dhe takimeve me grupet kryesore të interesit. Nga studimi u sigurua një përmbledhje e progresit të bërë në implementimin e rekomandimeve te ROSC dhe të cështjeve të pazgjidhura që kanë ende nevojë të adresohen.

Për sa i përket kuadrit institucional, KKD ka identifikuar grupet e interesit që do të luajnë një rol vendimtar në implementimin e ketij dokumenti politikash dhe planit te veprimit. Një rol të rëndësishëm për te luajtur në këtë drejtim kanë, në mënyrë direkte apo indirekte, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Banka Qëndrore e Shqipërisë, Autoriteti Mbikqyrës Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, IEKA, Shoqatat profesionale, akademikët, dhomat e tregtisë & shoqata të tjera, gjyqësori dhe publiku në përgjithësi.

Shtylla Kryesore 1: Përmirësimi i Kuadrit Institucional

Arritja e një kuadri konsistent, të parashikueshëm dhe praktik në raportimin financiar të korporatës përbën një nga standartet referuese kryesore për një sistem të fortë financiar.

Për zhvillimin e këtij kuadri, objektivi primar është sigurimi i një mënyre të balancuar për raportimin financiar dhe kërkesave të auditimit në Shqipëri, që plotëson nevojat e përdoruesve të ndryshëm të informacionit financiar, që është konsistent, i parashikueshëm dhe ç'ka është më e rëndësishme nuk imponon detyrime të panevojshme mbi sektorin e korporatave.

Siç është theksuar në seksionin 1.3 *acquis communautaire* përbën një pikë referuese themelore për realizimin e një kuadri të tillë. Adoptimi i një kuadri të fortë për raportimin financiar, i përgatitur posaçërisht për nevojat e ekonomisë Shqiptare dhe në pajtim me acquis communautaire të BE-së dhe praktikave më të mira ndërkombëtare do të sigurojë bazën për një kuadër raportimi financiar konsistent dhe praktik në Shqipëri. *(Key Pillar 1: Sub Activity 1 Overall Action 1)*



Figura 1-2: Shtylla Kryesore 1: Përmirësimi i Kuadrit Institucional

Një mjedis i fortë për raportimin financiar kërkon një fluks të qëndrueshëm ekspertësh kontabël të kualifikuar në menyrën e duhur. Megjithatë, aktualisht kuadri i kontabilitetit dhe auditimit për nxjerrjen e ekspertëve të rinj kontabël kërkon përmirësim dhe ndryshim. Duhet të ngrihet një qendër e re. Si fillim, kjo qendër do të zhvillojë një kurrikulë të re dhe më pas në bazë të kësaj kurrikule do të krijohet procesi i vlerësimit. Organet e kontabilitetit dhe auditimit do të vazhdojnë të trainojnë studentët në bazë të kurrikulave të tyre të reja dhe qendra do të menaxhojë dhe përditësimin e rishikimin periodik të kurrikulës mbi të cilën bazohet vlerësimi. *(Shtylla Kryesore 1:Aktiviteti 2 Veprimi i Përgjithshëm 2)*

Profesioni i audituesit duhet të zhvillojë rregullat e tij të brendshme dhe procedurat sic është përcaktuar në aktivitetet për të mbështetur profesionin në këtë strategji. Megjithatë, duke pasur parasysh skandalet e fundit botërore në fushën e kontabilitetit ndërkombëtar (Enron, Parmalat etj.) dhe për shkak të legjislacionit të fundit të Bashkimit European (Direktiva e Re e Tetë lidhur me Ligjin për Shoqëritë Tregtare mbi Auditimin Statutor), në Shqipëri duhet të zbatohet një sistem për mbikëqyrjen e jashtme e të pavarur publike të profesionit të audituesit. Për më tepër, mbikëqyrja publike efikase ndaj profesionit të audituesit është një element vital në ruajtjen dhe rritjen e besimit në funksionin e audituesit. *(Shtylla Kryesore 1:Aktiviteti 3 Veprimi i Përgjithshëm 3)*

Kuadri i kontabilitetit kërkon një Këshill Kombëtar Kontabiliteti të fortë dhe të gjerë për të përmbushur kërkesat rregullatore dhe vendosjen e standarteve për profesionin e kontabilitetit. *(Shtylla Kryesore 1:Aktiviteti 42 Veprimi i Përgjithshëm 4)*

Shtylla Kryesore 2: Forcimi i Kapaciteteve Institucionale

Ky dokument politikash mori parasysh eksperiencën e Shteteve Anëtare të BE nëpërmjet pranimit të faktit se një raportim i përmirësuar financiar i korporatave duhet të implementohet dhe imponohet nga institucionet e pajisura me burimet e përshtatshme. Për shembull, Banka Qendrore e Shqipërisë duhet të luajë një rol kyç në imponimin e IFRS (SNRF) nëpërmjet fuqive të veta ligjore dhe kërkesave të kujdesshme të raportimit.

Objektivi i këtyre masave është prezantimi i një sistemi rigoroz zbatimi.që funksionon në bashkëpunim me një kuadër të përshtashëm raportimi të korporatave për të krijuar një raportim me cilësi të lartë në Shqipëri.

Kjo pjesë e planit është ndarë në dy seksione kryesore: Organe Rregullatore dhe Organe Profesionale / Universitete.

Organe Rregullatore



- Figura 1-3: Shtylla Kryesore 2: Forcimi i Kapaciteteve Institucionale

Sektori bankar në tërësi përfaqëson një segment të rëndësishëm si të përgatitësve ashtu edhe të përdoruesve të raportimit financiar të korporatave në Shqipëri dhe përbën në këtë mënyrë një fushë vendimtare mbi të cilën duhet krijuar pritshëmria dhe besimi për realizimin e raportimit financiar me cilësi të mirë.

Për Bankën Qendrore të Shqipërisë, ky program do të rishikojë legjislacionin dhe rregullimet e aplikueshme në sektorin bankar për të siguruar përputhjen e kuadrit legjislativ me pjesët përkatëse të *acquis communautaire* dhe për të siguruar përputhshmërinë e legjislacionit bankar me legjislacionet e tjera vendase që lidhen me të. Dokumenti i politikave do të ndihmonte ndjeshëm Departamentin e Mbikëqyrjes në Bankën Qendrore në drejtim të forcimit të kapacitetit institucional për të mbikqyrur, monitoruar dhe zbatuar IFRS (SNRF) në raportimin financiar bankar *(Shtylla Kryesore 2:Aktiviteti 1 Veprimi i Përgjithshëm 5)*

Raportimi i tatimeve në Shqipëri përdor aktualisht një pjesë të konsiderueshme të aftësive kontabiliste në vend. Burimet e përdorura për të qartësuar, thjeshtuar dhe bashkërenduar mjediset e raportimit financiar dhe tatimor do të kontribuojnë në mënyrë të ndjeshme në rëndësinë e përgjithshme që i jepet raportimit financiar në Shqipëri, duke çuar në përmirësim të

raportimit financiar në periudhë afatgjatë. Për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, dokumenti i politikave do të ndihmonte në ngritjen e një kuadri statutor (ligjor) që siguron një bazë tatimore të parashikueshme dhe në hartimin e një proçesi efiçent për vlerësimin tatimor duke reduktuar koston e shoqërive për arritjen e përputhshmërisë *(Shtylla Kryesore 2:Aktiviteti 2 Veprimi i Përgjithshëm 6)*

Zhvillimi i sektorëve financiarë të specializuar në fushat që përfshijnë sigurimet dhe pensionet është një objektiv strategjik për çdo vend që aspiron në zhvillimin e një ekonomie të fuqishme dhe në rritje. Këto fusha të specializuara kanë nevojë për raportim financiar dhe supervizim të specializuar. Për Autoritetin e Shërbimeve Financiare, dokumenti i politikave do të ndihmonte realizimin e një legjislacioni konsistent dhe kuadri rregullator që mbështet një mjedis raportimi të modernizuar për sektorin e sigurimeve në linjë me *acquis communautaire*. Për më tepër, dokumenti i politikave do të ndihmonte zhvillimin e aftësisë për të monitoruar dhe siguruar përputhshmërinë me legjislacionin për raportimin financiar dhe rregullat për tregjet e kapitaleve në Shqipëri *(Shtylla Kryesore 2:Aktiviteti 3 Veprimi i Përgjithshëm 7)*

Programet për forcimin institucional dhe statutor (ligjor) do të ndihmojnë në përgatitjen e raportimit financiar me cilësi të lartë që do të plotësojë nevojat e një game të gjerë përdoruesish si investitorë, huadhënës dhe kreditorë. Një raportim financiar me cilësi të lartë përbën një kusht paraprak për mbledhjen e fondeve në tregjet e kapitaleve dhe sektorin bankar, të cilat janë thelbësore për rritjen ekonomike.

Megjithatë këto llogari vjetore me cilësi të lartë dhe llogaritë e konsoliduara janë të dobishme vetëm nëse mund të sigurohen ne mënyrë të shpejtë dhe të lehtë nga publiku. Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dokumenti i politikave do të siguronte që legjislacioni dhe rregulloret Shqiptare të përputhen me pjesët përkatëse të *acquis communautaire* që lidhen me publikimin dhe depozitimin e informacionit financiar përfshirë parimin e publikimit të detyruar, kërkesat minimale për transparencë të jane në përputhje me legjislacione të tjera kombëtare që lidhen me to. Për më tepër, dokumenti i politikave do të kontribuonte në përmirësimin e dukshëm të disponibilitetit të publikut të informacionit cilësor financiar nëpërmjet një programi me mbështetje operacionale, *hardware dhe software*. Këto veprime do të ndihmojnë palët e interesuara të kenë akses të shpejtë dhe të lehtë në llogaritë vjetore elektronike dhe llogaritë e konsoliduara të shoqerive tregtare *(Shtylla Kryesore 2:Aktiviteti 4 Veprimi i Përgjithshëm 8)*

Shtylla Kryesore 2: Organet Profesionale dhe Universitetet

Efektiviteti i adoptimit të një kuadri të përmirësuar të raportimit të korporatave varet në shkallë të gjerë nga respektimi i tij nga sipërmarrjet. Forcimi i rregullatorëve kryesorë është një mënyrë për të siguruar respektimin nga ndërmarrjet të kërkesave të raportimit të korporatave. Auditimi statutor i llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara të përzgejdhura (p.sh. llogaritë vjetore

të njësive ekonomike me interes publik) përbën një mënyrë tjetër efikase për të nxitur respektimin e standarteve të raportimit financiar.

Shqipëria duhet të përmirësojë këtë shtyllë themelore për të siguruar cilësinë dhe përputhshmërinë e raportimit financiar të korporatave – prania e një profesioni të besueshëm dhe të pavarur të auditimit me besnikëri maksimale ndaj kreditorëve të shoqërive, aksionerëve, dhe pjesëmarrësve të tjerë. Mbështetja dhe zhvillimi i profesionit të auditimit dhe kontabilitetit në Shqipëri është perceptuar si një objektiv qëndror i këtij dokumenti te politikave dhe plan veprimit.



Figura 1-4: Shtylla Kryesore 2: Organet Profesionale dhe Universitet

Në mbështetjen e drejtpërdrejtë të profesionit të auditimit, dokumenti i politikave do të ndihmojë Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë për t'u zhvilluar më tej si një organ profesional plotësisht i aftë për të realizuar detyrat e tij rregulluese dhe mbikëqyrëse lidhur me auditimin që i nënshtrohet mbikëqyrjes publike në Shqipëri.

Një organ i konsoliduar profesional auditimi me kompetenca dhe burime të mjaftueshme për të ndikuar në cilësinë e auditimit do të çojë në një rritje të cilësisë së raportimit financiar në Shqipëri. *(Shtylla Kryesore 2:Aktiviteti 5 Veprimi i Përgjithshëm 9)*

Veprimi do të rrisë efikasitetin e institutit vendor në sigurimin e kushteve për rritjen e cilësisë së shërbimeve të auditimit në Shqipëri. Burimet që nevojiten për të bërë të mundur përmirësimin e stukturës së institutit vendor dhe të mënyrës së tyre të të vepruarit (*modus operandi)* do të përdoren me efikasitet, nëse arrijnë të mbështesin

strukturat që do të bëjnë të mundur suksesin e tij në të ardhmen. Përputhja me Deklaratat për Detyrimet e Anëtarësimit (DDA) të IFAC do të ofrojë standarde/pika referimi të qarta për të ndihmuar institutin që të sigurojë performancë të një cilësie të lartë nga audituesit profesionistë.

Në mënyrë të dukshme, profesioni i kontabilistit ka nevojë për mbështetje dhe ky dokument i politikave do ta realizojë këtë në mënyrë konçize dhe të bashkërenduar. Dokumenti i politikave do të mbështesë cilindo organ kontabiliteti në zhvillimin dhe zbatimin e proçeseve dhe proçedurave të strukturuara, do të mundësojë zhvillimin e një mënyre funksionimi (*modus operandi)* efikase të organizatës që është në pajtim me praktikat e mira ndërkombëtare. Qëllimi është të rregullohet siç duhet profesioni i kontabilistit pa dëmtuar konkurrencën dhe të sigurohet mbrojtja e palëve të treta të cilët përftojnë shërbimet e ofruara nga një kontabilist i miratuar. *(Key Pillar 2: Sub Activity 6 Overall Action 10)*

Organet profesionale të kontabilitetit me aftësi dhe burime të mjaftueshme do të kontribuojnë ndjeshëm në cilësinë e raportimit financiar në Shqipëri. Aktivitetet do të forcojnë besueshmërinë e raportimit financiar në Shqipëri dhe do të ndihmojnë në formalizimin e ekonomisë informale duke nxitur kështu rritjen ekonomike.

Raportimi financiar i korporatës luan një rol vendimtar në një ekonomi bashkëkohore tregu që funksionon mirë. Të kuptuarit qartë nga brezat (gjeneratat) e ardhshëm të sipërmarrësve, avokatëve, bankierëve, kreditorëve dhe sigurisht audituesve statutorë (ligjorë) Shqiptarë të rolit të rëndësishëm që luan raportimi financiar me cilësi të lartë në një ekonomi të suksesshme do të rrisë në masë të gjerë mundësitë për zhvillimin e ekonomisë Shqiptare në të ardhmen.

Të kuptuarit e këtij realiteti realizohet me anë të një programi të fortë mësimor për kontabilitetin dhe auditimin në nivelin e tretë të arsimit në Shqipëri. Kjo është e rëndësishme jo vetëm në mënyrë të drejtëpërdrejtë për studentët e kontabilitetit por edhe për degët e tjera (psh. administrim biznesi, drejtësi, ekonomiks) për të siguruar që të gjithë sektorët e një ekonomie funksionale të mund të marrin vendime të mirëinformuara e të bazuara në të dhëna financiare të besueshme.

Për shembull, sipërmarrësit e ardhshëm duhet të vlerësojnë përfitimet potenciale që rrjedhin nga rritja e cilësisë në llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara, drejtuesit e shoqërive të listuara duhet të kuptojnë se kostoja e kapitalit zvogëlohet me rritjen e raportimit financiar dhe publiku në përgjithësi duhet të ndërgjegjësohet për rëndësinë e besimit që duhet patur në llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të shoqërive tregtare që investojnë ndjeshëm në pensione.

Burimet e ofruara për të filluar një program me aktivitete që çojnë në ngritjen e nivelit të programit mësimor të kontabilitetit do të çojnë në një përmirësim të njohurive të atyre që futen në programet e trajnimeve në fushën e auditimit në periudhën afatgjatë. Me rëndësi gjithashtu

është edhe fakti që njohuritë e thelluara të të gjithë studentëve të nivelit të tretë që kanë zgjedhur të ndjekin modulin e kontabilitetit do të ndikojnë në zgjerimin e bazës së njohurive të përgjithshme në lidhje me rëndësinë e një raportimi të mirë financiar të korporatës *(Shtylla Kryesore 2:Aktiviteti 7 Veprimi i Përgjithshëm 11)*

Shtylla Kryesore 3: Rritja e Ndërgjegjësimit për Raportimin Financiar të Korporatës dhe Auditimin

Nxitja e ndërgjegjësimit në lidhje me publikimin e informacionit dhe transparencën e korporatës në lidhje me raportimin financiar në periudhën afatgjatë do të çojë në rritjen e besimit në raportimin financiar në Shqipëri, do të rrisë kërkesën e publikut për transparencë dhe publikim të mirë të informacionit të korporatës, do të zvogëlojë rrezikun për mashtrime të mëdha nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit të të drejtave dhe përgjegjësive të njeriut dhe do të thellojë njohuritë vendase për raportimin financiar duke rritur bazën e mundshme investitore në Shqipëri.

Ky dokument i politikave përfshin një program për ndërgjegjësimin e publikut i hartuar dhe zbatuar në mënyrën e duhur që të çojë në rritjen e kërkesës së publikut për një raportim të mirë financiar të korporatës në Shqipëri *(Shtylla Kryesore 3:Aktiviteti 1 Veprimi i Përgjithshëm 12)*



Figura 1-5: Shtylla Kryesore 3: Rritja e Ndërgjegjësimit për Raportimin Financiar të Korporatës dhe Auditimin

Të kuptuarit e kërkesave të raportimit financiar të korporatës mund të jetë i rëndësishëm për mbrojtjen e palëve kyçe të përfshira. Ekonomitë nuk mund të zhvillohen pa investitorë. Investitorët në shoqëritë tregtare duhet të kenë një farë mbrojtje nëse drejtuesit ose menaxhimi i kanë keq drejtuar ose neglizhuar detyrimet e besushëmrisë (fiduciary duties). Proçesi gjyqësor është një element kyç në transaksionin e përgjithshëm të korporatës midis palëve të përfshira-

aksionerëve, drejtuesve, dhe shtetit (legjislativi, ekzekutivi, and gjyqësori). Investitorët kanë njëfarë besimi në rolin e gjykatave në imponimin e detyrimeve të besueshmërisë. Dokumenti i politikave konfirmon se sistemi gjyqësor ka nevojë për një program trajnimi të hartuar dhe implementuar mire që do të rriste njohuritë e gjyqtarëve për të kuptuar rëndësinë e raportimit të mire financiar të korporatës dhe përgjegjësitë dhe të drejtat e palëve përkatëse *(Shtylla Kryesore 3:Aktiviteti 2 Veprimi i Përgjithshëm 13).*

1.5 Kërkesat për financimin e dokumentit te politikave dhe planit të veprimit

Për adresimin e kërkesave të buxhetit dhe burimeve, KKD i ka ndarë kërkesat sipas fushave specifike, të cilat janë:

- **Asistencë teknike e jashtme me kualifikim të përshtatshëm**: Kjo ka një rëndësi të veçantë duke pasur parasysh natyrën teknike të shumë prej aktiviteteve dhe kërkesën për të thithur sa më shumë praktika të mira ndërkombëtare
- **Mbështetja operacionale**: KKD ka identifikuar nevojën për mbështetje direkte operacionale për palët e përfshira të përcaktuara në strategji dhe në planin e veprimit. Një mbështetje e tillë operacionale është e rëndësishme kryesisht në fazën fillestare të disa aktiviteteve dhe do të ndërpritet mbas një periudhe një deri tre vjeçare në varësi të aktiviteteve.
- ***Hardware, Software* & Pajisje**: KKD ka përcaktuar gjithashtu kërkesën për nevoja specifike për hardware, software dhe pajisje si një kërkesë shtesë e rëndësishme për burime të jashtme. Gjithashtu, asistenca teknike rajonale do t'i japë mundësi Shqipërise të shkëmbejë eksperienca me vende të rajonit dhe të përfitojë nga ekonomitë e shkallës në fusha teknike specifike. KKD ka identifikuar dokumentin (projektin) e Bankës Botërore Rruga për në Europë – Programi i Reformës në Kontabilitet dhe Forcimin Institucional (REPARIS) si një mënyrë për ofrimin e asistencës teknike rajonale[3].

1.6 Implementimi i dokumentit të politikave dhe planit të veprimit

Për çdo aktivitet të paraqitur në kapitullin 4, në këtë dokument politikash tregohet objektivi që duhet të realizohet, një përshkrim i detajuar i detyrës, dhe rezultati që do të arrihet. Lidhjet ndërmjet veprimeve janë të zakonshme. Janë identifikuar organet për realizimin e secilit aktivitet, si dhe janë specifikuar përgjegjësitë, përgjegjshmëritë dhe kuadret e qarta kohore për realizimin e veprimeve.

Janë llogaritur kostot për çdo veprim, dhe burimet që nevojiten janë ndarë midis atyre që duhet te sigurohen nga burimet e brendshme dhe ato që duhet të sigurohen nga burime të jashtme. Kërkesat për burime të jashtme janë klasifikuar në kategori të veçanta të tilla si asistencë teknike ose ndihmë në hardware.

---

[3] Për detaje të mëtejshme, të lutem referohju www.worldbank.org/reparis

1.7 Hapat e tjerë...

Dokumenti i politikave dhe plani i veprimit të vendit synojnë të jenë gjithashtu baza për diskutime mbi asistencën teknike me partnerët e zhvillimit. Tashmë që plani dhe dokumenti i politikave të vendit janë hartuar është e domosdoshme ngritja e një grupi këshillimi për të garantuar implementimin e tij. Është propozuar që Ministri i Financave duhet të vendosë për krijimin e këtij grupi këshillimi.

2 HYRJE

2.1 Konteksti strategjik

Një sistem i shëndoshë për raportimin financiar të korporatës përbën themelin e një ekonomie tregu që funksionon mirë dhe bazat e një sistemi të fortë financiar.

Në zhvillimin e një dokumenti te politikave për rritjen e cilësisë në raportimin financiar të korporatës në Shqipëri, është e rëndësishme të merren parasysh faktorët "frenues" dhe "nxitës" që motivojnë zhvillimin e kësaj strategjie.

- Faktorë frenues konsiderohen krizat financiare dhe skandalet e korporatave që kanë ndodhur nga fundi i viteve '90 në zhvillimin e tregjeve dhe gjatë viteve të fundit në vendet e industrializuara. Raportimi financiar me cilësi të lartë ndihmon në shmangien e këtyre skandaleve, të cilat kanë kosto tepër të larta ekonomike dhe shoqërore. *Për shembull:*
- Krizat e sistemit financiar në Azinë Jug-lindore që erdhën si rezultat i praktikave të dobëta në raportimin financiar të korporatës patën pasoja të rënda makro-ekonomike në vende si Tailanda (Produkti i Brendshëm Bruto (PBB-GDP) minus 10% në 1998), Koreja e Jugut (PPB (GDP) minus 7% në 1998) dhe Indonezia (PPB (GDP) minus 13% në 1998). Çka është më e rëndësishme, këto kriza patën një efekt negativ disproporcional mbi të varfërit në reduktim të regjistrimit në shkolla, ndërlikime të rënda shëndetësore,etj;
- Enron depozitoi kërkesën për falimentim në vitin 2001 duke rezultuar në një humbje prej US$67 bilion në kapitalizimin e tregut. Si rrjedhojë, mijëra punëtorë në mbarë botën humbën punën si dhe mijëra punëtorë dhe pensionistë humbën një masë të konsiderueshme nga pensionet e tyre;
- Parmalat raportoi vlerën e huave me rreth US$14 billion më pak (se vlera reale). Si rezultat, 36,000 vende pune në 65 vende u vunë në rrezik dhe 5,000 fermerëve ende u detyrohet shuma prej US$150 million, ose US$30,000 për fermer.

Këto skandale paraqesin një tablo tepër të qartë për efektet negative të raportimit të dobët financiar të korporatës. Në të kundërt, raportimi i mirë financiar është i favorshëm për zhvillimin e sektorit financiar dhe sektorit privat, të cilët së bashku nxisin rritjen ekonomike. Marrëdhënia midis raportimit financiar të korporatës me cilësi të lartë dhe zhvillimit të sektorëve financiar dhe privat funksionon nëpërmjet disa parametrave:

- Së pari, nëpërmjet forcimit të strukturës financiare vendase dhe reduktimit të rrezikut për kriza në tregun financiar dhe impakteve negative ekonomike që i shoqërojnë;

- Së dyti, duke kontribuar në investimet e huaja direkte dhe të portofolit dhe duke ndihmuar në shfrytezimin e kursimeve vendase. Investimet e huaja direkte (FDI) janë zhvilluar me hapa të ngadalta duke dëmtuar negativisht punësimin në vend;
- Së treti, duke lehtësuar aksesin e korporatave të vogla huamarrëse për kredi nga sektori financiar formal nëpërmjet zvogëlimit te kostove te larta të informacionit dhe huamarrjes;
- Së katërti, duke lejuar investitorët të bëjnë vlerësimet e duhura të perspektivave të korporatës dhe për të marrë vendime të mirë-informuara për investimet dhe votimet, të cilat rezultojnë në një alokim më të mirë të burimeve. Raportimi financiar i korporatës shërben gjithashtu si instrument për monitorimin e bazuar në treg duke lejuar aksionerët dhe publikun e gjerë të vlerësojnë performancën e menaxhimit të një shoqërie tregtare, pra duke nxitur zhvillimin aktiv te tregjeve kapitale; dhe
- Së fundi, duke mbështetur integrimin ekonomik, rajonal dhe global.

2.2 Baza për zhvillimin e kësaj strategjie

Në 2006, një ekip i Bankës Botërore përgatiti një raport mbi Vëzhgimin e Standarteve dhe Kodeve (ROSC) për kontabilitetin dhe auditimin (A&A) në Shqipëri. Banka Botërore, Ministria e Financave dhe palët vendase të interesit ranë dakord mbi rekomandimet e politikës së ROSC. U ra gjithashtu dakord për zhvillimin dhe implementimin e një plan veprimi të detajuar në bazë të këtyre rekomandimeve. Dokumenti i politikve te vendit dhe plani i veprimit, që duhet të zhvillohen nga palët vendase të interesit , duhet të implementohen nga bashkërendimi i Ministrisë së Financave dhe me asistencë nga partnerët e zhvillimit.

Si përgjigje imediate ndaj A&A ROSC, Ministria e Financave ngriti një Komitet Kombëtar Drejtues (KKD) për zhvillimin e dokumentit të politikve dhe planit të veprimit për të adresuar rekomandimet e politikës së paraqitur në raportin e A&A ROSC me qëllim rritjen e cilësisë së raportimit financiar të korporatës.

KKD-ja është e përbërë nga një grup pjesëmarrësish të profesioneve të ndryshme në sektorin publik dhe atë privat të interesuar në raportimin financiar të korporatës. Ajo përfshin përfaqësues nga qeveria, rregullatorët e sektorit financiar, profesioni i kontabilitetit, akademikët, bankat tregtare, kompanitë e sigurimeve si dhe nga sipërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Roli dhe aktivitetet e KKD-së duhet të mbështesin përgatitjen e planit të veprimit dhe dokumentin e politikave për trajtimin e kërkesave të *acquis communautaire* lidhur me kontabilitetin dhe auditimin. Një program i Bankës Botërore për Asistencën Teknike ka mbështetur punën e KKD-së.

Dokumenti i politikave dhe plani i veprimit synojnë të jenë baza për diskutime mbi asistencën teknike me partnerët e zhvillimit. Me përfundimin e planit të veprimit, do të ketë nevojë për një grup këshillimi që të garantojë implementimin e reformave. Ministri i Financave do të vendosë mbi krijimin dhe strukturën e grupit të këshillimit.

2.3 Objektivat strategjike dhe përfitimet

Rritja e cilësisë së raportimit financiar të korporatës shtrihet përtej fushave specifike të kontabilitetit dhe auditimit. Objektivat strategjike dhe përfitimet janë përcaktuar më poshtë në Figure 2-1: Rëndësia e raportimit financiar të korporatës me cilësi të lartë.



Figura 2-1: Rëndësia e raportimit financiar të korparatës me cilesi të lartë

Dokumenti i politikave dhe plan veprimi synjnë një raportim më të mirë financiar të korporatës, d.m.th një mjet për të përfituar disa "të mira" ekonomike të paraqitura ne Figure 2-1 më sipër. Ajo është rreth realizimit të rritjes ekonomike dhe integrimit në BE përmes adoptimit dhe implementimit të pjesëve përkatëse të *acquis communautaire* dhe standarteve të tjera përkatëse.

Kjo do të rezultojë në një mjedis ku përdoruesit mund të kenë besim në raportimin financiar të korporatës për nevojat e tyre respektive siç është ilustruar në Figure 2-2: Përfitimet e Raportimit të mirë të Korporatës.



Figure 2-2: Përfitimet e Raportimit të mirë të Korporatës

2.4 Pikat referuese (Benchmarks)

Siç tregohet në Figure 2-3, Dokumenti i politikave të KKD-së për të forcuar kuadrin institucional dhe ligjor udhëhiqet nga një pikë parësore referimi që është *acquis communautaire* së bashku me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) dhe praktikat e mira ndërkombëtare.

acquis communautaire

Acquis communautaire ka rëndësi të dyfishtë për Shqipërinë. *Së pari*, ajo përfaqson një model te cilësisë së lartë për rregullimin e kontabilitetit dhe auditimit, që mund të aplikohet në shtete me karakteristika të ndryshme. *Së dyti*, adoptimi i *acquis communautaire*, në lidhje me kontabilitetin dhe auditimin, mbështet strategjinë e Shqipërisë për tu bërë pjesë e Bashkimit Europian.

Në këtë aspekt, KKD është ndikuar nga dy faktore për hartimin e këtij dokumenti te politikve dhe plan veprimi. së pari, në lidhje me zbatimin pritet që Shqipëria ka nevojë të demonstrojë se

jo vetëm ka adoptuar *acquis communautaire* në sistemin ligjor (kuadrin statutor) por së dyti, gjithashtu të tregoje se Shqipëria ka marrë masa për të siguruar që *acquis communautaire i cili* aktualisht po implementohet (kuadri institucional).

Përgatitja e një kuadri rregullator dhe institucional për kontabilitetin dhe auditimin me cilësi të lartë, kërkon kryerjen e reformave në sistemin ligjor, institucione, dhe profesionin e kontabilistit në Shqipëri, si edhe ndryshime në kulturën e kontabilitetit, auditimit dhe biznesit.

Ky dokumenti i politikave dhe plan veprimi përcakton një numër aktivitetetsh për reforma të hartuara në mënyrë tërësore duke marrë parasysh aftësinë e Shqipërisë për realizimin e aktiviteteve të tilla (në aspektin e kapciteteve dhe të burimeve).

Në disa raste, një rregull relativisht i butë i cili imponohet fuqishëm dhe në mënyrë konsistente është më i preferuar se një rregull i mirë dhe i fortë i cili është i paimponueshëm, pasi rregulli i butë mund të forcohet në mënyrë progresive sipas rrethanave. Si rezultat, KKD ka vendosur të hartojë reformat të cilat, megjithëse konsiderohen një sfidë, mund të realizohen në një periudhë afatshkurtër deri afat-mesme.

Standartet Nderkombëtare te Raportimit Financiar

Siç ilustrohet në Figure 2-3, KKD ka pasur në vëmendje përdorimin e SNRF si pike referimi referuese.[4] KKD është dakort me opinionin e përgjithshëm të raportit ROSC ("Është e nevojshme që të arrihet një ekuilibër midis përfitimeve të informacionit baze finaciar i cili lehtëson vendimet ekonomike dhe të biznesit dhe kostove të kërkesave të tepërta të raportimit") se SNRF janë të arsyeshme për tu aplikuar nga Njësitë me Interes Publik (PIE)[5] dhe se do të përbënin detyrim të tepërt për shumicën e SME-ve. Për këtë arsye, fakti qe KKD perdor SNRF si pikë referimi nuk do të thotë që SNRF janë të përshtashme për të gjitha shoqëritë tregtare.

Standartet Ndërkombëtare të Auditimit

KKD ka marrë gjithashtu parasysh standartet, kodet dhe deklaratat e publikuara nga Federata Ndërkombëtare e Ekspertëve Kontabël (IFAC) dhe komisionet e saj të pavarura, të cilat janë:

- Standartet Ndërkombëtare për Auditimin (ISA);[6]

---

[4] Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB), një organzatë ndërkombëtare e pavarur, përcakton SNRF.

[5] Në këtë dokument termi njësi me interes publik përdoret për t'ju referuar atyre njësive për të cilat publiku i përgjithshëm ka interes për shkak të natyrës së biznesit të tyre (p.sh. banka, kompani sigurimesh, etj) madhësisë së tyre, apo gamës së palëve të interesuara për ato.

[6] Këshilli i Garantimit të Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit i IFAC vendos Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA).

- Kodi i Etikës për Kontabilistët Profesionistë;[7]
- Standartet Ndërkombëtare të Arsimit (IES);[8] dhe
- Deklarata për Detyrimet e Anëtarësimit (SMOs).[9]

Ashtu si me SNRF (IFRS), KKD nuk i ka përdorur këto standarte, kode dhe deklarata si pika referimi absolute por është përpjekur të bazohet në ato për të plotësuar *acquis communautaire* në rastet kur *acquis communautaire* nuk është shumë specifik.

Praktikat e mira Ndërkombëtare

Së fundi, KKD është mbështetur në shembujt e sjellë nga praktikat e mira ndërkombëtare si një pikë e favorshme referimi për zhvillimin e dokumenti te politikve dhe planit të veprimit. Falë asitencës teknike të siguruar, për shembull nga programi i Bankës Botërore "Rruga për në Europë – Programi për Reformat në Kontabilitet dhe Forcimin Institucional" (REPARIS), KKD ka grumbulluar shembuj nga praktikat e mira ndërkombëtare dhe është mbështetur në këto njohuri për të kuptuar:

- Si e kanë adoptuar dhe implementuar *acquis communautaire* Shtetet Anëtare të BE; *dhe*
- Në fushat ku *acquis communautaire* është shumë i përgjithshëm ose nuk shprehet (p.sh., lidhjet midis raportimit të taksës së të ardhurave të korporatës dhe llogarive vjetore), cila strategji konsiderohet praktikë e mirë ndërkombëtare.

Pjesët përkatëse të *acquis communautaire*

KKD ka rishikuar *acquis communautaire* dhe e ka identifikuar Kapitullin 6, Ligji për Shoqëritë Tregtare, si veçanërisht të rëndësishëm për ngritjen e një sistemi të fortë raportimi financiar. Figure 2-4 tregon dallimin midis "ligjit të rreptë (ashpër)" dhe "ligjit të butë." Rregulloret (të detyrueshme për të gjitha Shtetet Anëtare të BE pa qenë nevoja për një legjislacion kombëtar implementimi të tyre) dhe Direktivat (të detyrueshme në lidhje me objektivat që duhet të arrihen dhe afatin kohor brenda të cilit ato duhet të realizohen

---

7 Kodi i Etikës për Kontabilistët Profesionistë zhvillohet nga Këshilli i Standarteve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët i IFAC.

8 Standartet Ndërkombëtare të Arsimit zhvillohen nga Keshilli I Standarteve Ndërkombëtare të Arsimit të Kontabilitetit i IFAC.

9 SMO-të shërbejnë si bazamenti për Programin e Përputhsmërisë së Organeve Anëtare, që mbikqyret nga Paneli Këshillimor i Përputhsmërisë së IFAC. SMO-të sigurojnë pika referuese të qarta për organet anëtare aktuale dhe të mundshëm për ti ndihmuar ato për sigurimin e performacave me cilësi të larte nga kontabilistët profesionistë.

Megjithatë, mënyra dhe mjetet për arritjen e këtyre objektivave janë zgjedhje e autoriteteve kombëtare) konsiderohen *"ligj i detyrueshëm(i fortë)"* Rekomandimet dhe Komunikimet konsiderohen "ligj jo i detyrueshëm(i butë)" Ligje të buta janë "rregullat e sjelljes të cilat, në parim, nuk kanë fuqi ligjore detyruese, por sidoqoftë mund të kenë efekte praktike."[10]

Corporate sector accounting & auditing within the *acquis communautaire*

<table>
<tr><th>LEGJISLACIONI</th><th colspan="3">KONTABILITET</th><th>AUDITIM</th><th></th></tr>
<tr><td rowspan="5">Rregulloret & Direktivat (Ligj i Forte)</td><td colspan="3">(A) DIREKTIVA E LLOGARIVE VJETORE (78/660/EEC)</td><td rowspan="2">(L) DIREKTIVA E AUDITIMIT STATUTOR</td><td rowspan="2">Berthama e pertashme</td></tr>
<tr><td colspan="3">(B) DIREKTIVA LLOGARIVE VJETORE TE KONSOLIDUARA (83/349/EEC)</td></tr>
<tr><td>BANKA</td><td>SIGURIME</td><td>TREGJET E KAPITALEVE</td><td rowspan="3"></td><td rowspan="3">Specifike per Sektoret</td></tr>
<tr><td>(C) DIRECTIVA E LLOGARIVE BANKARE (86/635/EEC)</td><td>(E) DIRECTIVA E LLOGARIVE TE SIGURIMEVE (91/674/EEC)</td><td>(G) RREGULLORJA E SNRF (NO. (EC) 1606/2002 PERFSHIRE RREGULLORET E COMISIONIT TE BE QE MIRATOJNE SNRF INDIVIDUALE)</td></tr>
<tr><td>(D) DIRECTIVA E KERKESAVE TE KAPITALIT</td><td>(F) DIRECTIVA AFTESISE PAGUESE (LIKUJDUESE) (2001/13/EC)</td><td>(H) DIRECTIVE PROSPECTUS (2003/71/EC)
(I) DIRECTIVA E TRANSPARENCES (2004/109/EC)
(J) DIRECTIVAT UCITS (2001/107/EC) & (2001/108/EC)</td></tr>
<tr><td>Rekomandimet & Komunikimet (Ligj i Bute)</td><td colspan="3">(K) KOMUNIKIM PER MODERNIZIMIN LIGJIT TE SHOQERIVE TREGTARE & PERMIRESIMIT TE GOVERNANCES SE KORPORATES NE BE (COM/2003/284)</td><td>(M) REKOMANDIMI PER PAVARESISNE E AUDITUESVE STATUTORE (2002/590/EC)
(N) REKOMANDIMI PER SIGURIMIN E CILESISE AUDITIMIN STATUTOR (2001/256/EC)</td><td></td></tr>
</table>

[10] Snyder, F. 1993. "Efikasiteti i Ligjit të Komunitetit Europian: Institucionet, Proçeset, Instrumentet dhe Teknikat."

Figura 2-4: Kontabiliteti dhe Auditimii Sektorit te Korporatave brenda *Acquis Communautaire*

Të gjitha këto Rregulla, Direktiva, Rekomandime dhe Komunikime të marra së bashku mund të konsiderohen si pjesa kryesore e *acquis communautaire*, lidhur me kontabilitetin në sektorin e korporatave. Një përmbledhje e shkurtër e Rregullave, Direktivave, Rekomandimeve dhe Komunikimive themelore është paraqitur më poshtë:

Direktivat Themelore të Kontabilitetit

(A) *Direktiva e Katërt për Llogaritë Vjetore (78/660/EEC):* Kjo Direktivë bashkërendon parashikimet (ligjore) e Shteteve Anëtare lidhur me paraqitjen dhe përmbajtjen e llogarive vjetore dhe raporteve vjetore të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar, parimet e përgjithshme për vlerësimin e elementëve përbërës në llogaritë vjetore (p.sh., prudence), rregullat specifike të vlerësimt (p.sh., rregullat e vlerësimit për pasuritë e paluajtshme), dhe publikimin e llogarive vjetore siç është paraqitur në Direktivën e Parë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (68/151/CEE), i ndryshuar.

(B) *Direktiva e Shtatë për Llogaritë e Konsoliduara (83/349/EEC):* Kjo direktivë bashkërendon ligjet kombëtare për llogaritë e konsoliduara (d.m.th., të grupit) dhe përcakton rrethanat në të cilat këto llogari duhet të përgatiten. Një shoqëri mëmë dhe të gjitha filialet e saj duhet të konsolidohen në atë rast kur shoqëria mëmë ose një ose më shumë filiale të saj janë përcaktuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Lidhur me këto dy direktiva, KKD ka marrë parasysh kërkesat e direktivës, e ndryshuar, dhe alternativat e ndryshme dhe pragjet maksimale, të cilat do të kërkojnë prej politikëbërësve Shqiptarë të përcaktojnë cilat alternativa dhe pragje janë të përshtatshme për kushtet e Shqipërisë.

Sektori Bankar

(C) *Direktiva për Llogaritë Bankare (86/635/EEC):* Për llogaritë vjetore të bankave dhe institucioneve të tjera kreditore, kjo direktivë përcakton rregullat lidhur me paraqitjen dhe matjen në ato fusha ku rregulla të tilla konsiderohen të nevojshme për shkak të natyrës së veçantë të këtij sektori.

(D) *Direktiva mbi Kërkesat e Kapitaleve:* Kjo Direktivë, e cila njihet në përgjithësi si Direktiva mbi Kërkesat e Kapitaleve por që teknikisht përfshin dy Direktiva, paraqet një kuadër mbikqyrës në BE, që pasqyron rregullat e Basel II mbi matjen dhe standartet e kapitaleve të miratuara në nivelin G-10. Direktiva e bën më të plotë dhe më të ndjeshëm ndaj rrezikut sistemin ekzistues dhe nxit menaxhimin e përmirësuar të rrezikut ndërmjet institucioneve financiare, duke rritur efikasitetin e sistemit në garantimin e stabilitetit të vazhdueshëm financiar, ruajtjen e besimit në institucionet financiare dhe mbrojten e konsumatorëve. Ajo është hartuar gjithashtu për të

garantuar që kërkesat e kapitaleve për huadhënie ndaj SMEs janë të përshtatshme dhe proporcionale. Vendet Anëtare të BE e kanë nisur zbatimin e Direktivës prej fillimit të 2007, ndërsa strategjitë më të sofistikuara do të jenë gati në 2008. Ndërsa Direktiva mbi Kërkesat e Kapitaleve nuk është një Direktivë "kontabiliteti" në vetvete, KKD e ka marrë parasysh me qëllim që të garantojë se reformat për raportimin financiar në kuadrin e strategjisë dhe planit të veprimit janë të favorshme për strategji më të mira dhe konsistente në mbikëqyrjen bankare.[11]

Sektori i Sigurimeve

(E) *Direktiva e Llogarive të Sigurimeve (91/674/EEC):* Për llogaritë vjetore dhe të konsoliduara të sipërmarrjeve të sigurimeve, kjo Direktivë përcakton rregullat specifike lidhur me paraqitjen dhe matjen në ato fusha ku rregulla të tilla konsiderohen të nevojshme për shkak të natyrës së veçantë të sektorit të sigurimeve.

(F) *Direktivat e Aftësisë së Pagimit (Shlyerjes):* Një Kompani Sigurimi duhet të ketë aftësi paguese që është e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e saj ndaj personave të siguruar dhe palëve të tjera. Me qëllim garantimin e mbrojtjes së barabartë të interesave të personave të siguruar si dhe krijimin e kushteve të njëjta të konkurrencës midis sipërmarrjeve, sipërmarrjet e sigurimeve në vendet e BE ju nënshtrohen kërkesave të njëjta për normën e shlyerjes.

KKD ka marrë në konsideratë sistemin aktual të aftësive paguese, sistem i cili kohët e fundit u ndryshua dhe u përditësua si pjesë e paketës "Aftësia Paguese I", përfshirë direktivat 2002/13/EC (sigurimi jo të jetës) dhe 2002/83/EC (sigurimi I jetës). Gjithashtu., KKD ka marrë në konsideratë efektet e projektit ""Aftësia paguese II", i cili analizon cështje të tilla si metodë më e bazuar në rrezik, harmonizimi i vendosjes së dispozitave teknike, teknikat e reja të transferimit të rrezikut dhe zhvillimet më të fundit në raportimin financiar.

Tregjet e Kapitaleve

(G) *Rregullorja (BE) Nr.1606/2002 e Këshillit dhe Parlamentit Europian:* Rregullorja detyron kompanitë e listuara, përfshirë bankat dhe kompanitë e sigurimeve, qe të përgatisin llogaritë e tyre të konsoliduara në përputhje me SNRF duke filluar nga viti 2005. Vendet Anëtare te BE kanë gjithashtu alternativën e aplikimit të kërkesave të kësaj Rregulloreje edhe për kompanitë e palistuara si edhe për përgatitjen e llogarive vjetore. Rregulloret e Komisionit Europian aprovojnë standarte sic janë rënë dakort dhe kur janë të nevojshme .[12]

---

[11] Për të reduktuar barrierat (pengesat) që rrjedhin nga përgjegjësitë e autoriteteve mbikëqyrse të caktuara kombëtare, mbikqyrësit duhet të punojnë më afër me njëri-tjetrin, duke përfshirë edhe marrjen e vendimeve mbi zbatimin nga institucionet financiare përdorimin e metodologjive më të sofistikuara. Komiteti i Mbikëqyrësve Bankar Europian (CEBS) duhet të luajë një rol të rëndësishëm në nxitjen e përputhshmërisë së qëndrimeve ndërmjet mbikëqyrësve të ndryshëm.

[12] P.sh. Rregullorja (EC) No. 1725/2003 më 29 Shtator, 2003 (plus anekset) aprovoi të gjitha Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASs) ekzistuese, përfshirë Interpretimet Komsionit të Standarteve (SICs) te lidhura me to, përvec IAS 32 dhe 39 and ato te lidhur me keto SICs 5, 16 dhe 17, të cilat kane lidhje me kontabilitetin dhe publikimin e instrumentave financiarë.

(H) *Direktiva e Prospektit (2003/71/EC):* Kjo Direktivë së bashku me Rregulloren e Komisionit Europian Nr. 809/2004 paraqet informacionin që përmbajnë këto prospekte (broshura) si edhe formatin dhe rregullat për publikimin e këtyre broshurave dhe përhapjen e reklamave. Ajo përbën themelin për krijimin e tregut të vetëm të shërbimeve financiare dhe për përfundimin e planit të veprimit të BE-së për Shërbimet Financiare.

Nëpërmjet koordinimit të kërkesave të nevojshme për publikim, sistemi i ri ligjor në tërësi krijon një "pasaportë të vetme" me vlerë si për publikuesit që janë anëtarë të BE dhe për ata që nuk janë. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë që nëse një broshurë është miratuar nga një shtet anëtar I BE-së, ajo mund të përdoret edhe nga shtetet e tjera, duke shmangur burokracitë dhe kostot për botuesit. Në lidhje me situatën në Shqipëri, KKD ka marrë parasysh sugjerimet e Direktivës për raportimin financiar të korporatës dhe Rregulloren e Komisionit Europian veçanërisht në lidhje me tregjet e reja të kapitaleve.

(I) *Direktiva për Transparencë (2004/109/EC):* Kjo Direktive përcakton kërkesat minimale për transparencë për shoqëritë tregtare të listuara, duke rritur cilësinë e informacionit që disponojnë investitorët për performancën e shoqërive tregtare dhe pozicionin financiar. KKD i ka kushtuar vëmendje kërkesave për publikim të përcaktuara në Direktivë, të cilat plotësojnë një paketë masash të planit të veprimit të BE-së në lidhje me Shërbimet Financiare, përfshirë Rregulloren 1606/2002 dhe Direktivën e Prospektit (shiko më sipër).

Sipas kësaj Direktive, të gjithë emetuesit e letrave me vlerë duhet të dorëzojnë raporte financiare vjetore brenda katër muajve pas përfundimit të vitit financiar. Gjithashtu, investitorët në aksione do të përftojnë raporte financiare më të plota çdo gjashtë muaj.

(J) *Direktiva (85/611/EEC) për Sipërmarrjet për Investimin Kolektiv të Letrave me Vlerë të Transferueshme (UCITS):* Direktiva, e ndryshuar, përcakton rregullat e përgjithshme për të lejuar sipërmarrjet e investimeve kolektive të Shteteve Anëtare të Be-së t'i tregtojnë njësitë e tyre në Shtete të tjera anëtare (pasaportë e vetme). KKD i ka kushtuar rëndësi efekteve të Direktivës lidhur me raportimin financiar të korporatës.

Komunikimi Themelor i Kontabilitetit

(K) *Komunikimi mbi Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Drejtimin e tyre (COM/2003/284):* Komiteti Europian bëri një konsultim rreth Komunikimit të Komisionit për "Modernizimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe Përmirësimin në Drejtimin e tyre në Bashkimin Europian: Plani për të Ecur Përpara." Plani, i adoptuar në 21 Maj, 2003, propozoi një grup iniciativash me qëllim forcimin e të drejtave të aksionerëve, përforcimin e mbrojtjes së punëtorëve dhe kreditorëve, si dhe rritjen e efiçensës dhe konkurrencës në biznesin Europian.

Direktiva Themelore për Auditimin

(L) *Direktiva për Auditimin Statutor (ligjor):* Kjo Direktivë (që njihet gjithashtu si "Tetë Direktivat e Reja të BE-së për Ligjin për Shoqëritë Tregtare"), e cila do të zëvendësojë Direktivën e Tetë ekzistuese (84/253/EEC), qartëson detyrat e audituesve statutor (ligjor) dhe përcakton disa

parime etike për të garantuar objektivitet dhe pavarësi. Ajo paraqet më shumë një kërkesë – se sa një rekomandim – për të garantuar cilësinë e jashtme, për të siguruar mbikëqyrjen e fuqishme publike ndaj profesionit të audituesit, dhe për të përmirësuar bashkëpunimin midis autoriteteve rregullatore në BE. KKD i ka kushtuar vëmendje kësaj direktive të re me qëllim propozimin e reformave të tjera në disa fusha ku ligji shqiptar për auditimin që ka hyrë në fuqi kohët e fundit, ndryshon nga Direktiva.

Rekomandimet Themelore për Auditimin

(M) *Rekomandimi 2002/590/EC mbi Pavarësinë e audituesve statutorë (ligjor) në BE:* Rekomandimi nxjerr në pah një numër parimesh të nivelit të lartë dhe sugjeron se audituesit statutorë e kanë të ndaluar të kryejnë kontrolle financiare (audite) nëse ata kanë marrëdhënie me klientët e tyre, gjë kjo që kompromenton pavarësinë e tyre. Megjithëse Rekomandimi nuk është ligjërisht i detyrueshëm, ai na jep një pikë të qartë referimi të praktikave të mira për sektorin e auditimit në BE dhe KKD i ka kushtuar vëmendjen e duhur.

(N) *Rekomandimi 2001/256/EC mbi Garantimin e Cilësisë për Auditimin Statutor (ligjor):* Rekomandimi përcakton standartet minimale për sistemet e jashtme të garantimit të cilësisë lidhur me auditimin stautor në BE. Qëllimi i garantimit të cilësisë është të sigurojë që auditimet statutore të (ekzekutohen)kryhen në përputhje me standartet e vendosura të auditimit dhe që audituesit të respektojnë rregullat e etikës, përfshirë edhe pavarësinë.

3 Raporti I Bankës Botërore ROSC

Ne vitin 2006 Banka Botërore kreu një analizë të detajuar të mjedisit të kontabilitetit dhe auditimit në Shqipëri. KKD ka përdorur këtë analizë dhe rekomandimet e tij si bazë per Planin e Veprimit të vendit.

Konkluzionet Kryesore

Vlerësim i Përgjithshëm: Kuadri Rregullator

- Kuadri ligjor për raportimin financiar në Shqipëri, karaktarizohet nga mungesë e bashkë - rendimit. Gjithashtu, ligjet dhe rregulloret duhet tu komunikohen në mënyrën e duhur njësive ekonomike të cilat pritet të zbatojnë ato në mënyrë që të lehtësohet përputhshmëria me ligjin.
- Në Shqipëri informacioni financiar i publikuar është shumë i kufizuar. Kerkesat aktuale për depozitimin dhe publikimin e pasqyrave financiare nuk janë në linjë me praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë, për shembull me kërkesat e Direktivës së Parë, të Katërt dhe të Shtatë të Ligjit të Shoqërive Tregtare të BE.
- Një ligj i ri për kontabilitetin synon të adresojë shumë prej mangësive të kërkesave të mëparshme të raportimit financiar dhe të kontabilitetit. Kërkesat e kontabilitetit në ligjin e mëparshëm të kontabilitetit, Planin e Përgjithshëm të Kontabilitetit, dhe Udhëzuesin e Kontabilitetit të Bankave nuk ishin të mjaftueshme për të siguruar informacion financiar me cilësi të lartë për njësitë ekonomike me interes publik, informacion mbi bazen e të cilit përdoruesit mund të bëjnë vendimarrje ekonomike të mirë informuar. Këto ligje nuk mbulonin aspekte të rëndësishme si: konsolidimi; qeradhënia; kontratat e ndërtimit; dhe zhvlerësimi i mjeteve. Ligji i ri i kontabilitetit përpiqet të adresojë këto probleme nëpërmjet kërkesës për përdorimin e Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) nga njësitë ekonomike me interes publik dhe përdorimi i kërkesave të thjeshtëzuara për raportim financiar nga SME-të.

Vlerësim i Përgjithshëm: Kapaciteti Institutional dhe Profesional

- Krijuesi i standarteve të kontabilitetit, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK) ka nevojë për shumë më tepër burime teknike dhe financiare për të përmbushur mandatin e tij. Si një organ i pavarur KKK do të jetë përgjegjëse për të siguruar fondet e veta dhe stafin përkatës për aktivitetet e veta.
- Në të gjitha fushat e ekonomisë ka një nevojë të konsiderueshme për trajnime në lidhje me kontabilitetin, auditimin dhe raportimin financiar. Gama dhe cilësia e shkollimit dhe trajnimit të kryer në proceset e para dhe pas çertifikimit për kontabilistët dhe auditorët është e pamjaftueshme për të adresuar nevojën aktuale për njohuri dhe eksperiencë. Rregullatorët, ekipet menaxhuese të kompanive, palët e interesit, kontabilistët, auditorët dhe pedagoget kanë nevojë për trajnime te nivelit fillestar deri të avancuar.
- Mekanizmi i monitorimit dhe zbatimit nuk janë të efektshëm për të nxitur përputshmërinë me standardet e kontabilitetit dhe auditimit. Me përjashtim të Bankës së Shqipërisë zbatimi i standardeve të kontabiliteteit është i kufizuar. Arsyet për monitorim dhe zbatim jo të efektshëm përfshijnë autoritete ligjore të paqarta, mungesa e kapaciteteve apo autoritetit operativ, paaftësia e njësive për të përmbushur detyrimet për shkak të kufizimeve në

kapacitete, dhe neglizhenca nga autoritetet për të përmbushur këtë rol të rëndësishëm. Përvec kësaj, autoriteti zbatues është i shpërndarë midis shumë organeve rregullatore çka çon në inefiçiensa të mëtejshme. Në lidhje me standardet e auditimit, monitorimi dhe zbatimi nuk janë të efektshëm për shkak të ekspertzës së kufizuar për kryerjen e analizave të firmave audituese, veçanërsisht të atyrë që auditojnë njësi me interes publik.

Vlerësim i Përgjithshëm: Funksioni i auditit

- Kuadri rregullator për funksionin e auditimit është përgatitur në linjë me direktivën e 8-të të BE, megjithëse funksioni i auditit ka nevojë të fitojë më shumë besueshmëri. Përdoruesit kanë shumë pak besim në opinionet e auditit të lëshuara nga auditorë lokalë. Ka shumë pak auditorë të cilët kanë njohuritë dhe përvojën për të kryer auditime sipas standardeve ndërkombëtare. Cilësia e auditimit përkeqësohet për shkak të një sezoni të shkurtër auditimi, shumë njësi ekonomike me madhësi të mesme kanë detyrim për auditim, dhe për shkak të evazionit fiksal
- Në disa raste auditorët nuk konsiderohen të jenë të pavarur nga njësitë e audituara. Ky është një problem me shume dimensione, që është i lidhur me mungesën e sisetemeve efektive të sigurimit (garantimit) të cilësisë-objekt i mbikqyrjes publike-për monitorimin e cilësisë së auditimit dhe përputhshmërinë me kërkesat e pavarësisë.
- Periudhat e shkurtra të rotacionit të detyrueshëm të firmave të auditimit në sektorët e bankave dhe të sigurimeve kanë rezultuar në një situatë jo-konkurruese dhe mund të kenë pasoja të paparashikuara në cilësinë e auditimit. Vetëm katër firma auditimi janë të autorizuara për të audituar bankat dhe dy për kompanitë e sigurimve. Prezantimi i një rotacioni të detyrueshëm të firmës audituese në periudha dy vjecare për kompanitë e sigurimeve, dhe tre vjet për bankat kufizon zgjedhjen e firmës audituese kur kjo është e kombinuar me kërkesat e pavarësisë. Kjo i vendos bankat dhe kompanitë e sigurimeve përballë një mungese të theksuar alternativash për zgjedhje në kontraktimin e shërbimeve të auditimit.

Recommendime për politikën

Rekomandim i nivelit të lartë 1:

- Rekomandohet që kuadri statutuor ne lidhje me kontabilitetitn, auditimin dhe raportimin financiar të përmirësohet duke përdorur një metodë tërësore, duke marre në konsideratë ligje dhe rregullore të tjera, përfshirë ligjin e shoqërive tregtare, ligjin e taksave etj. Rekomandohet të krijohet një grup nga profesione të ndryshme për te ndërmarrë veprimet në vijim:

- Një rishikim tërësor të të gjithë legjislacionit qe ka lidhje me kontabilitetin, auditimin dhe raportimin financiar me qëllim identifikimin e kërkesave të paqarta apo kontradiktore, përfshirë ato në lidhje me konsolidimin dhe standartet e kontabilitetit të aplikueshme për institucionet ndërmjetese financiare jo-bankare dhe ato mikrofinanciare
- Përgatitjen e një ligji për auditimin në përputhje me Direktvën e tetë të BE për Ligjin e shoqërive tregtare, që të përfshijë, por jo i kufizuar në krijimin e një sistemi të mbikqyrjes publike për profesionin e audituesit, sigurim më të mirë të cilësisë për auditimet statutore, dhe rregulloreve për regjistrimin e audituesve vendas dhe të huaj, përfshirë firmat e auditimit.
- Vendosje e pragjeve të pranueshëm për kërkesa të thjeshtëzuara të raportimit financiar dhe përjashtim nga detyrimi për audit vjetor, duke përfshirë vlerat e përafërta të përdoruara për të përcaktuar njësitë ekonomike të fuqishme. Kjo do të shmangë ngarkesën e SME-ve me kërkesa të tepërta të raportimit financiar dhe auditimit. Nga ana tjetër, këto do të sigurojnë që *njësitë me interes publik* të jenë objekt i kërkesave më të rrepta për transparencë dhe publikim. Kjo duhet të bëhet nëpërmjet një analize të strukturës së biznesit në Shqipëri.
- Kërkesën për njësitë ekonomike me interes publik për të vënë në dispozicion të publikut pasqyra financiare të njësive përkatëse legale (dhe të konsoliduara), brenda një periudhe kohore pas përgatitjes së Bilancit.
- Harmonizimi i kuadrit të taksave me legjislacionin e kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar. SNRF dhe KKK do të prezantojnë kategori të reja të të ardhurave dhe shpenzimeve, prandaj udhëzimet do të duhet të nxirren për mënyrën se si do të pajtohen fitimi/humbja kontabël me fitimin/humbjen e tatueshme. Në mungesë të udhezimeve, njësitë do të përziejne standardet e kontabilitetit dhe të taksave për përgatitjen e raporteve financiare.

Rekomandim i nivelit të lartë 2:

- Rekomnadohet që të përmirësohet struktura e krijimit të rregullave te kontabilitetit për ta bërë më të qëndrueshme. Kjo do të kërkonte:
- Zgjerimin e organit aktual të përditësimit të standardeve për të përfshirë një gamë më të gjerë palësh interesi me qëllim që nevojat e palëve të interesit të sektorit privat dhe publik të adresohen në mënyrë sistematike në procesin e krijimit të standarteve, përfshirë përshtatjen e objektit të zbatimit të SNRF dhe SKK, domethënë kerkesa të thjeshtëzuara raportimi për SME-te dhe kërkesa më rigoroze për njësitë me interes public.

- Mobilizimi i fondeve dhe ekspertzies teknike për të siguruara që standardet e kontabilitetit janë të përditësuara.
- Dokumentimi, shpërndarja dhe zbatimi i një strategjie të qartë për draftimin dhe adoptimin e standardeve, të cilat përfshijnë një proçes efektiv këshillimi. Kjo do të ndihmojë në adresimin e shkallës së ulët të ndërgjegjësimit dhe zbatimit të standarteve të kontabilitetit.
- Eksplorimi i sinergjive në lidhje me përkthimin e standardeve të kontabilitetit dhe auditimit në përputhje me Fondacionin e Këshillit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASCF) dhe politikat e përkthimit të IFAC. KKK duhet të eksplorojë mundësitë e bashkëpunimit me krjuesit e standardeve të auditimit, përfshirë bashkimin e burimeve dhe përdorimin e software-ve të përbashkët.
- Rregullatorët e bankave dhe të sigurimeve duhet të angazhohen në forume ndërkombëtare për të eksploruar marrëdhëniet midis pasqyrave financiare të kujdesit (prudenciale) dhe atyre për qëllime të përgjithshme, për të krijuar filtra te kujdesshëm. Kjo do të adresonte shqetësimet e rregullatorëve se zbatimi i SNRF mund të rrezikojë kriteret rregullatore për fondet e veta dhe të krijojë paqëndrueshmëri në pasqyrat financiare. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë duhet t'i kushtojë vëmendje (i) përdorimit nga institucionet kreditore dhe firmat e investimeve të udhëzimeve për një kuadër të përbashkët raportimi (COREP) 22, kur ato sipas Direktivës se Kërkesave të Kapitalit i raportojnë autoriteve mbikqyrëse normën e tyre të shlyerjes së detyrimeve, dhe (ii) udhëzimeve që vendosin një kuadër të standartizuar të raportimit financiar (FINREP) për institucionet e kreditit që kanë aktivitet në BE. Ky kuadër lejon institucionet e kreditit që për raportimin prudencial të përdorin të njëjtat formate të dhënash të standardizuara dhe përkufizime të të dhënave në të gjitha vëndet ku kuadri aplikohet, duke zvogëluar ngarkesën e raportimit për institucionet e kreditit që operojnë në vende të ndryshme, dhe zvogëlon pengesat për zhvillimin e një tregu të brendshëm efiçient për shërbimet financiare. Kjo është veçanërsisht e rëndësishme në kontekstin e Shqipërisë ku një pjesë e konsiderueshme e sektorit bankar zotërohet nga të huajt.

Rekomandim i nivelit të lartë 3:

- Rekomandohet të krijohet një strukturë e qëndrueshme e krijimit të standardeve të auditimit. Kjo do të bënte të nevojshme:
- Krijimin e një procesi të qëndrueshëm në përditësimin e standardeve të auditimit, dhe zhvillimin e praktikave të përshtatshme auditimi, veçanërisht për SME-të.

Rekomandim i nivelit të lartë 4:

- Rekomandohet të krijohen mekanizma sistematikë institucionalë të monitorimit dhe zbatimit, për të siguruar përputhshmëri me standardet e kontabilitetit dhe auditimit. Kjo do të kërkonte:
- Përditësimin e legjislacionit për të përcaktuar në mënyrë të qartë autoritetin e organeve rregullatore për të detyruar zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe auditimit dhe për të modernizuar sanksionet aktuale në mënyrë që ato të jenë më efektivë. Shqipëria mund të dëshirojë që të marrë në konsideratë parimet e zbatimit të standardeve të kontabilitetit të hartuara nga Komisioni i Rregullatorëve Europianë të Letrave me Vlerë, megjithëse këto parime janë hartuar në kontekstin e kompanive të listuara në bursë. Raporte kualifikuese të auditimit (me vlerësim negativ për njësinë e audituar) duhet të çojnë në hetime të njësive dhe raporte jokualifikuese të auditimit (me vlerësim pozitiv për njësinë e audituar), të cilat duhet të ishin kualifikuese, duhet gjithashtu të çojne ne hetim të kompanisë së auditimit.
- Krijimin e një sistemi për garantimin e cilësisë i cili është objekt i mbikëqyrjes publike. Garantimi i cilësisë për audituesin statutor (ligjor) është thelbësor për të siguruar cilësi të mirë të auditimit, i cili rrit besueshmërinë në informacionin financiar të publikuar si dhe rrit vlerën dhe nivelin e mbrojtjes për aksionerët, investitorët, kreditorët dhe palët e interesit. Sistemi mund të bazohet në praktikat ekzistuese të Shteteve Anëtare të BE-së, veçanërisht të vendeve që iu bashkuan BE-së në 1 Maj 2004, të cilave ju është dashur të zbatojnë sisteme të garantimit të cilësisë në rrethana të ngjashme, megjithëse jo identike, me Shqipërinë. Gjithashtu IFAC SMO 1, Garantimi i Cilësisë, është një udhëzues i dobishëm në këtë aspekt. Rezultatet e sistemit të jashtëm të garantimit të cilësisë duhet të përfshihen në programin e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional dhe/ose në sistemin disiplinor, sipas rastit.
- Kërkesa për audituesit statutorë dhe firmave të auditimit që kryejnë audite statutore të njësive me interes publik, të përgatisin dhe të publikojnë raporte vjetore të transparencës. Këto raporte duhet të përfshijnë një përshkrim të rrjetit dhe rregullimeve të tij ligjore dhe strukturore, nëse firma e auditimit i përket një rrjeti, informacion mbi strukturën drejtuese të firmës së auditimit; një përshkrim të sistemeve të brendshme të kontrollit të cilësisë; një listë të njësive me interes publik të cilat janë audituar nga firma e auditimit gjatë viteve; dhe informacion tjetër të rëndësishëm që do të ndihmonte përdoruesit e pasqyrave financiare për te rritur besimin në cilësinë e auditimit.

- Krijimin e një sistemi efikas të hetimeve dhe sanksioneve për të zbuluar, korrigjuar dhe parandaluar ekzekutimin jo në mënyrën e duhur të auditimit statutor. Sistemi mund të sigurojë ndëshkime civile, administrative ose kriminale të cilat janë efikase, proporcionale dhe disiplinuese për audituesit statutor dhe firmat e auditimit, në rastet kur auditimet nuk kryhen në përputhje me Ligjin e Auditimit, ISA, dhe/ose Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë. Gjthashtu, çdo masë të marrë ose sanksion i vendosur ndaj audituesve statutor dhe firmave të auditimit duhet t'i informohet publikut në mënyrën e duhur. Sistemi mund të bazohet në praktikat aktuale të Vendeve Anëtare të BE dhe IFAC SMO 6 hetimi dhe disiplina është një udhëzues i dobishëm për këtë çështje.
- Plotësimin me staf, në terma të numrit dhe ekspertizës, të organeve përgjegjëse për monitorim dhe zbatim. Kontrollorët duhet të kenë ekspertizë në kontrollin e pasqyrave financiare për të përcaktuar nëse janë respektuar standartet e kontabilitetit. Në të njëtën mënyrë, kontrollorët e firmave të auditimit duhet të kenë aftësinë të vlerësojnë nëse mekanizmat e kontrollit brenda firmës janë të përshtatshëm dhe efikas për të siguruar kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë.
- Përmirësimin e regjistrit të audituesve statutor dhe firmave të auditimit në mënyrë që palët e interesuara të mund të përcaktojnë me shpejtësi nëse një auditues statutor apo një firmë auditimi është aprovuar apo jo, etj. Kjo do të lehtësohet nëpërmjet regjistrimit në regjistër elektronik publik. Disponueshmëria e regjistrit publik në gjuhë të huaj do të rriste në mënyrë të ndjeshme dobishmërinë e tij veçanërsisht në konteksin e invetimeve të huaja direkte apo të portofolit.

Rekomandim i nivelit të lartë 5:

- Rekomandohet që të përmirësohet profesionalizmi dhe cilësia e punës së kryer nga profesionet e kontabilistëve dhe audituesve. Kjo do të lehtësohej nëpërmjet:
- Qartësimit të mandatit të IEKA për të përfshirë kryerjen e punëve në shërbim të interesit publik.
- Heqjen e përcaktimit të normës së pagesës së auditimit nga Qeveria, e cila aktualisht kufizon qëllimin dhe cilësinë e punës së audituesve. Në vend të kësaj, më shumë rëndësi duhet t'i jepet kontrollit të garantimit të cilësisë dhe procesit të hetimit dhe disiplinës për të monitoruar pavarësinë e audituesve dhe cilësin e auditimit.
- Kërkimit të anëtarësimit (të plotë) në organet ndërkombëtare, si IFAC dhe, më vonë në Federatën Europiane të Kontabilistëve. Anëtarësimi në këto organe ndërkombëtare shpesh siguron disiplinën dhe strukturën për të ndihmuar organet profesionale vendase që të aderojnë në standarde minimale, që ndihmojnë në përmirësimin e tyre.

- Qartësimit të rolit dhe përgjegjësive të Kontabilistëve të Autorizuar dhe marrje ne konsideratë e avantazheve të fuqizimit rregullator.

Rekomandim i nivelit të lartë 6:

- Ne lidhje me kualifikimin dhe trajnimin, rekomandohet që të rritet numri i profesionistëve kontabël dhe auditues,të cilët janë të aftë të përgatisin pasqyra finnaciare me cilësi të lartë dhe të kryejnë auditime me cilësi të lartë, respektivisht. Duhet të nisin gjithashtu inisiativa për të tërhequr studentë të shkëlqyer në profesion dhe për të rritur njohjen e kualifikimeve të kontabilitetit dhe auditimit në Shqipëri. Kjo do të kërkonte:
- Rishikimin e kurrikulës së kontabilitetit të universitetit për të përfshirë më shumë materiale mbi SNRF, ISA, etikën e biznesit dhe drejtimin e korporatës.
- Sigurimin e stimujve për individë që do t'i bashkohen profesionit (të kontabilistit). Stimujt mund të krijohen nëpërmjet ofrimit nga njësitë e qeverisë dhe të bizneseve të bursave për studentë të kontabilitetit.
- Përditësimin e standarteve të kualifikimit në linjë me IFAC IES. Kjo do të përfshinte përditësimin e përmbajtjes të programit të provimit profesional, përmbajtjes së provimit profesional dhe vlerësimin e provimit në mënyrë që të përfshijnë pjesë të rëndësishme të cilat aktualisht nuk janë të përfshira. Kjo do të sillte që profesinistët të jenë më mirë të kualifikuar, të kenë njohje më të mirë të kualifkimive. Duke marrë në konsideratë kufizimet e burimeve në Shqipëri, duhet të shfrytëzohen sinergjitë midis edukimit dhe kualifikimit të kontabilistëve dhe audituesve.
- Koordinimin dhe lehtësimin e kurseve të trajnimit, veçanërisht në fushat e SNRF dhe ISA, kurse të zhvilluara nga ekspertë rajonalë dhe ndërkombëtarë. Kurset e kontabilitetit dhe auditimit duhet të vazhdojnë nga niveli fillestar deri në nivel të avancuar. Gjithashtu, kurset duhet të ofrohen në fusha te specializuara si raportimi financiar dhe auditimi i bankave dhe kompanive të sigurimeve.
- Nëpërmjet monitorimit sistematik të anëtarëve për përputhshmërinë me CPD dhe marrjen në konsideratë të mundësisë së heqjes së licensave anëtarëve për mos-përputhshmëri.
- Vendosje ose ri-vendosjes së lidhjeve me organet ndërkombëtare profesionale të kontabilitetit.

4 PLANI I DETAJUAR SIPAS SHTYLLAVE KRYESORE TË AKTIVITETEVE

Gjatë zhvillimit të dokumentit të politikave dhe planit të veprimit KKD identifikoi shtyllat kryesore të aktiviteteve në kuadrin institucional dhe ligjor. Secila prej shtyllave kryesore të aktiviteteve dhe secili aktivitet specifik përfaqëson një fushë në të cilën objektivat e identifikuara do të çojnë në një kuadër të përmirësuar të kontabilitetit dhe auditimit në Shqipëri dhe do të rrisin cilësinë dhe besueshmërinë e raportimit financiar të korporatës.

Në identifikimin e veprimeve që duhen ndërmarrë për shtyllat kryesore të aktiviteteve dhe aktivitetet specifike, u përcaktuan gjithashtu edhe institucionet përkatëse me të cilat ato kanë lidhje. Veprimet përcaktojnë qartë përgjegjësitë dhe përgjegjshmëritë për realizimin e veprimeve të kërkuara për arritjen e një faze të suksesshme implementimi pas pranimit të dokumentit të politikave dhe planit të veprimit. Veprimet gjithashtu përcaktojnë në mënyrë të detajuar grupet e interesit të cilat kanë një rol të rëndësishëm në këto aktivitete.

KKD ka identifikuar ndarjen kohore për çdo aktivitet specifik brenda çdo shtylle aktiviteti. Në trajtimin e kërkesave të buxhetit dhe burimeve, KKD ka bërë një ndarje të kërkesave në burime të jashtme dhe të brendshme:

Për burimet e jashtme KKD ka bërë një ndarje të kërkesave në fusha specifike:

- ✓ Asistencë teknike e jashtme me kualifikim të përshtatshëm: Kjo ka një rëndësi të veçantë duke pasur parasysh natyrën teknike të shumë prej aktiviteteve dhe kërkesën për të thithur sa më shumë praktika të mira ndërkombëtare. Ndonëse një pjesë e konsiderueshme e kësaj asistence do të jetë specifike për Shqipërinë, ka edhe raste të tjera ku asistenca teknike mund të ofrohet në bazë rajonale me qëllim që vendi të ketë mundësi të fitojë ekspertizë e cila nuk mund të sigurohet në forma të tjera.
- ✓ Asistenca teknike rajonale do ti japë mundësi vendit të shkëmbejë eksperiencën me vende të ngjashme në rajon dhe të kursejë nga ekonomitë e shkallës në fusha teknike specifike. KKD ka identifikuar dokumentin (projektin) e Bankës Botërore Rruga për në Europë – Programi i Reformës në Kontabilitet dhe Forcimit Institucional (REPARIS) si një mënyrë për ofrimin e asistencës teknike rajonale.
- ✓ KKD ka identifikuar nevojën për mbështeje direkte operacionale për grupet e interesit të përcaktuara në strategji dhe në planin e veprimit. Një mbështetje e tillë operacionale është shumë e rëndësishme sidomos në fazën e parë të disa prej aktiviteteve dhe do të ndahet në faza të tjera gjatë një periudhe prej një deri në tre vjet në vartësi të aktiviteteve.
- ✓ KKD gjithashtu ka identifikuar kërkesat për nevoja specifike për hardware, software dhe pajisje, si një kërkesë të rëndësishme shtesë për burime të jashtme.

Në identifikimin e nevojave për mbështetje të brendshme KKD i ka kushtuar vëmendje kërkesave për mbështetje specifike nga grupet e interesit të konsideruara si të përgjegjëshme ose përgjegjëse për veprimet (burimet e brendëshme).

4.1 Shtylla Kryesore 1: Forcimi i Kuadrit Institucional:

4.1.1 Aktiviteti 1: Dorëzimi i një Kuadri Ligjor të Plotë, Konsistent dhe Praktik

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet dokumentit te politikave dhe këtij plan veprimi. Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

Adoptimi i një kuadri të mirë të raportimit financiar në përputhje me nevojat e ekonomisë së vendit dhe i përshtatur me *acquis communautaire* (kuadrin ligjor të BE-së) dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Përshkrimi

Ky aktivitet do të përqëndrohet në forcimin e kuadrit ligjor për të siguruar:

Plotësinë

- Përgatitjen dhe adoptimin e një ligji të ri, për auditimin në përputhje me direktivën e BE mbi Auditimin Statutor i cili do të sigurojë një bazë ligjore për arsimimin dhe liçensimin e audituesve, standardeve të auditimit, mbikëqyrjen e auditimit, sigurimin e cilësisë etj.

Qëndrueshmërinë

- Rishikimin e legjislacionit aktual të kontabilitetit, auditimit dhe raportimin financiar për të identifikuar mospërputhjet dhe për të eliminuar paqartësitë.
- Përshtatjen e kërkesave të raportimit financiar të korporatës (në sektorin financiar dhe jo-fianciar) siç janë identifikuar në legjislacionin parësor dhe dytësor me ato të *acquis communautaire*.

Prakticiteti

-
    - Adoptimin me sukses të pragjeve për kërkesat e thjeshtuara të raportimit financiar dhe adoptimi (ose zhvillimi) i standardeve të thjeshtuara të kontabilitetit për SME-të.
    - Adoptimin me sukses të legjislacionit të ri i cili vendos një urë të përshtatshme fiskale për të mbështetur adoptimin e standardeve të reja të kontabilitetit.
    - Adoptimin me sukses të kërkesave për depozitim dhe publikim të informacionit dhe raportimit specifik financiar nga njësitë ekonomike me interes publik.

Rezultati

Të sigurohet një metodë e ekuilibruar për kërkesat e raportimit financiar dhe auditimit në mënyrë që:

- Të plotësohen nevojat e përdoruesve të ndryshëm të informacionit financiar të tillë si huadhënësit, kreditorët, aksionerët, SME-të dhe auoritetet tatimore;
- Hartuesve tu sigurohet një numër kërkesash të cilat nuk krijojnë pengesa të tepërta për sektorin e korporatës.
- Të sigurohet një bazë e fortë për një infrastrukturë të përshtatshme të raportimit financiar dhe auditimit.

Grupet Kryesore të Interesit

- Komiteti i Zbatimit të Projektit (Komiteti Kombëtar Drejtues)
- Ministria e Financës
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
- Qendra e kurrikulave
- Organizatat profesionale
- Bordi i propozuar i Mbikëqyrjes së Auditimit
- Autoritetet tatimore

4.1.2 Aktiviteti 2: Krijimi "Qëndër Kurikule"

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet këtij dokumentit te politikave dhe këtij plan veprimi. Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

Kuadri i kontabilitetit dhe auditimit për nxjerrjen e kontabilistëve ka nevojë për përmirësim dhe ndryshim. Duhet të ngrihet një qendër e cila fillimisht do të zhvillojë një kurrikulë të re dhe më pas në bazë të kësaj kurrikule do të krijohet procesi i vlerësimit. Organet e kontabilitetit dhe auditimit do të vazhdojnë të trajnojnë studentët në bazë të kurrikulave të tyre të reja dhe qendra do të menaxhojë përditësimin dhe rishikimin periodik të kurrikulës mbi të cilën bazohet vlerësimi.

Përshkrimi

Synimi i Qëndrës është të fokusohet në menaxhimin dhe miratimin e kurrikulës dhe përgatitjen e kandidatëve. Këto programe do të hartohen paraprakisht dhe propozohen nga organe të autorizuara profesionale kontabiliste dhe audituese të përshtatura në bazë të standardeve ndërkombëtare duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Kualifikimit të propozuara nga IFAC dhe kërkesat për kualifikim të Direktivës së BE për Auditimin Statutor. Veprimtaritë do të përfshijnë:

Ngritjen e "Qender e Kurikulave" nën vartësi të Ministisë së Financave:

Zhvillimin e një kurrikule të re për programe profesionale trajnimi mbi kontabilitetin dhe auditimin në Shqipëri

- Zhvillimin dhe mbajtjen e një kurrikule për kualifikimin dhe trajnimin profesional të auditimit duke pasur parasysh standardet ndërkombëtare[13]:

[13] Nenet 6, 7 dhe 8 të Direktivës së Tetë të BE për Ligjin e Shoqërive Tregëtare;
Standardin Ndërkombëtar të Kualifikimit/Arsimimit Nr. 1 të IFAC, Kërkesat e pranimit në një program të kualifikimit profesional të kontabilitetit;
Standardin Ndërkombëtar të Kualifikimit/Arsimimit Nr. 2 të IFAC, Përmbajtja e Programeve Kualifikuese Profesionale të Kontabilitetit;
Standardin Ndërkombëtar të Kualifikimit/Arsimimit No. 3 të IFAC, Aftësitë Profesionale;
Standardin Ndërkombëtar të Kualifikimit/Arsimimit Nr. 4 të IFAC, Vlerat Profesionale, Etika dhe Qëndrimet;
Standardin Ndërkombëtare të Kualifikimit/Arsimimit Nr. 5 të IFAC, Kërkesat e Praktikës Profesionale;
Standardin Ndërkombëtare të Kualifikimit/Arsimimit Nr. 6 të IFAC, Vlerësimi i Aftësive dhe Kompetencave Profesionale.

Zhvillimin dhe drejtimin e një programi të përshtatshëm vlerësimi për profesionistët e auditimit dhe kontabilitetit në Shqipëri

- Zhvillimin dhe drejtimin e një programi vlerësimi për certifikatën profesionale të auditimit në bazë të Standardeve të Kualifikimit/Arsimimit të IFAC dhe Direktivës së 8 të BE-së
- Zhvillimin e një programi vlerësimi për certifikimin profesional në fushën e kontabilitetit në bazë të Standardeve të Arsimimit të IFAC.

Detajimi i procesit të provimit për kontabilistët dhe audituesit do të kryhet sipas standarteve IFAC. Për të ndihmuar këtë proces ne kemi përfshirë në Aneks B një përshkrim të detajuar të këtyre kërkesave dhe proceseve.

Mbështetjen e organeve profesionale të auditimit dhe kontabilitetit për zhvillimin e një programi trajnimi të krahasueshëm me kurrikulën e re të parashikuar në këtë aktivitet.

- Krijimin e kapaciteteve për administrimin e pranimit të studentëve të rinj në programin e trainimit.
- Krijimin e kapaciteteve për t'u siguruar që studentët e pranuar kanë kualifikimin e përshtatshëm duke përfshirë të dhëna të Kërkesave të Pranimit në një Program Kualifikimi/Arsimimi Profesional Kontabiliteti.
- Zhvillimin e materialeve të duhura për mësimdhënien e kurrikulës.
- Identifikimin e programit mësimor; organizimin e kalendarit të trajnimit, marrjen /punësimin e lektorëve, dhe nëse kërkohet organizimi i kurseve.
- Krijimin e kapaciteteve për t'u siguruar që studentët e pranuar kanë kualifikimin e përshtatshëm duke përshirë edhe Kërkesat e Praktikës Profesionale.
- Vënien në përdorim të një metode të drejtë për vlerësimin e aftësive dhe kompetencave/aftësive profesionale;

Financimi i qendrës, në periudhë afat gjatë duhet të koordinohet nga shteti, nga anëtarë dhe aplikuesit për provime si dhe nga grupe të tjera përkatëse të interesit. Parashikohet që financimi fillestar i qendrës do të mbulojë zhvillimin e dokumentit te politikave i cili do të japë në mënyrë të detajuar çeshtjet specifike të financimit dhe grupeve të interesit.

Standardin Ndërkombëtar të Kualifikimit/Arsimimit Nr. 7 të IFAC Zhvillimi i Vijueshëm Profesional. Një program i të Mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimi i vijueshëm i aftësive profesionale;
Standardin Ndërkombëtar të Kualifikimit/Arsimimit Nr. 8 të IFAC, Kërkesat e aftësive në profesionin e auditimit; dhe
Eksperiencat e vendeve anëtare të BE-së në hartimin e programeve arsimore/kualifikuese të cilat kanë në mënyrë të detajuar kerkesat specifike për procesin e provimit siç kërkohet ng IFAC. Për të ndihmuar në këtë proces, në shtojcën A është dhënë një përshkrim i detajuar i këtyre kërkesave dhe proceseve

Dokumenti i politikave duhet të trajtojë gjithashtu çështjet e vijueshmërisë dhe tranferimit të njohurive duke përfshirë programe specifike për trajnimin e trajnerve me anë të programit të financuar fillimisht me burime të jashtme.

Rezultati

Një kuadër i përmirësuar institucional për kontabilitetin dhe auditimin i realizuar nga qendra e re e krjuar, qëndër përgjegjëse për aktivitetet kyçe që do të sigurojnë një profesion më të kualifikuar kontabiliteti dhe auditimi, të aftë për të përmbushur kërkesat e raportimit financiar në Shqipëri në një periudhë afatmesme.

Grupet Kryesore të Interesit

- Qendra e Kurikulave
- Komiteti për Zbatimin e Projektit (Komiteti Kombëtar Drejtues)
- Ministria e Financës
- IEKA, universitetet
- Organizatat profesionale

4.1.3 Activiteti 3: Përmirësimi i Kuadrit Institucional: Krijimi i Organit Mbikqyrës të Auditimit

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet këtij document te politikave dhe këtij plan veprimi. Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

Duke u nisur nga skandalet ndërkombëtare të kohëve të fundit në fushën e kontabilitetit (Enron, Parmalat etj.) dhe duke marrë në konsideratë Legjislacionin e fundit të Bashkimit Evropian (Direktivën e 8^{të} të Ligjit për Shoqëritë Tregëtare për Auditimin Statutor) në Shqipëri duhet të zbatohet një sistem i jashtëm i pavarur i mbikëqyrjes publike në një afat të mesëm. Përveç kësaj, një mbikëqyrje publike efektive e profesionit të auditimit do të ishtë një element shumë i rëndësishëm në ruajtjen dhe përmirësimin e konfidencës në funksionin e auditimit.

Përshkrimi

Ky veprim do të mbështesë krijimin e strukturës operacionale të një Organi të ri për Mbikëqyrjen e Auditimit (OMA) në Shqipëri i cili do të zëvendësojë strukturën aktuale të mbikëqyrjes. Parimet kryesore për zhvillimin e këtij funksioni mbikqyrës jepen në Nenin 32 të Direktivës së 8 të BE për Ligjin e Shoqërive Tregëtare si më poshtë:

KAPITULLI VIII: MBIKËQYRJA PUBLIKE DHE ORGANIZIMI RREGULLATOR MES SHTETEVE ANËTARE

Neni 32: Parimet e mbikëqyrjes publike

1. Shtetet anëtare do të organizojnë një sistem efikas të mbikëqyrjes publike të audituesve dhe firmave të auditimit statutor në bazë të parimeve të paraqitura në paragrafet 2 deri në 7.

2. Të gjithë audituesit dhe firmat e auditimit statutor do ti nënshtrohen mbikëqyrjes publike.

3. Sistemi i mbikëqyrjes publike do të drejtohet nga ekspertë që nuk e praktikojnë profesionin (por) të cilët kanë njohuri në fushat që lidhen me auditimin statutor.

Megjithatë, shtetet anëtare mund të lejojnë një pakicë ekspertësh që e praktikojnë profesionin të përfshihen në sistemin e mbikëqyrjes publike.

Personat e përfshirë në drejtimin e sistemit të mbikëqyrjes publike duhet të zgjidhen në bazë të një procedure të pavarur dhe transparente emërimi.

4. Sistemi i mbikëqyrjes publike duhet të ketë përgjegjësinë përfundimtare të mbikëqyrjes së:

(a) miratimit dhe regjistrimit të audituesve dhe firmave të auditimit statutor;

(b) adoptimit të standardeve të etikës profesionale, kontrollit të brendshëm së cilësisë së firmave të auditimit dhe të procesit të auditimit, dhe

(c) sistemeve të kualifikimit të vazhdueshëm, sigurimit të cilësisë dhe sistemeve të investigimit dhe disiplinës.

5. Sistemi i mbikëqyrjes publike do të ketë të drejtën, aty ku është e nevojshme, të kryejë investigime në lidhje me audituesit dhe firmat e auditimit statutor dhe të drejtën për të marrë masat e duhura.

6. Sistemi i mbikëqyrjes publike duhet të jetë transparent. Kjo do të përfshijë programet vjetore të punës dhe raportet e veprimtarive.

7. Sistemi i mbikëqyrjes publike duhet të ketë financimin e mjaftueshëm. Financimi duhet të jetë i sigurtë dhe i çliruar nga ndonjë influencë e audituesve apo firmave të auditimit statutor.

Në këto kushte, ky veprim do të mbështesë hartimin e një arkiterkture operacionale të një Organi të ri të Mbikëqyrjes së Auditimit (OMA) në Shqipëri duke përfshirë:

Fushën e zbatimit dhe kompetencat

- Fusha e zbatimit të mbikëqyrjes (p.sh., kualifikimi/arsmimi, licensimi, vendosja e standardeve, sistemet e kontrollit të cilësisë dhe të disiplinës).
- Kompetencat e mbikëqyrjes (p.sh., të drejtat investiguese dhe disiplinuese):
    - Për nxitjen e zbatimit të standardeve e larta profesionale të auditimit;
    - Për monitorimin e zbatimit të dispozitave të ligjit dhe rregulloreve përkatëse;
    - Për rishikimin e procedurave të marrjes së titullit ekspert kontabël i autorizuar/certifikuar nga IEKA, (Instituti i Kontabilistëve të Autorizuar);
    - Për monitorimin dhe dhënien e opinionit mbi propozimet dhe veprimet e përgjithëshme të IEKA-s; dhe
    - Për monitorimin e operimeve/aktiviteteve të IEKA-s në lidhje me veprimtarinë e anëtarëve të saj për sa i takon arsimimit, sistemit të sigurimit të cilësisë dhe etikës profesionale.
- Transparenca e mbikëqyrjes (p.sh. publikimi i programeve vjetore të punës dhe raporteve të veprimtarive).

Financimi

- Financimi i sistemit të mbikëqyrjes në mënyrë të sigurt dhe të lirë nga ndonjë influencë nga audituesit ose firmat e auditimit statutor.

Marrëdhëniet e jashtëme

- Të përgatitet një "Memorandum Mirëkuptimi" me partnerë të rëndësishëm të tillë si
- Banka Qendrore, Autoriteti Mbikëqyrës Financiar, Autoritetet Tatimore dhe MF.
- Përgatitja e një udhëzuesi ku përshkruhen organizimet në IEKA për sistemet e kontrollit të cilësisë dhe ato disiplinore, duke marrë në konsideratë:
    - Sistemet aktuale të kontrollit të cilësisë dhe ato disiplinore; dhe
    - Nevojën për bashkëpunim me autoritetet përkatëse të shteteve anëtare të BE-së sa herë është e nevojshme për qëllime të realizimit së përgjegjësive të mbikëqyrjes

publike sipas Direktivës së Tetë të BE-së për Ligjin për Shoqëritë Tregëtare. Në veçanti, sistemi do të sigurojë një shkëmbim të informacionit dhe bashkëpunim në investigimet që lidhen me kryerjen e auditimeve statutore.

Ky veprim do të zhvillojë fillimisht aftësitë e OMA duke përfshirë:

- Ngritjen e një Sekretariati – marrjen në punë dhe emërimin e stafit përkatës
- Implementimin e një plani burimesh për nevojat thelbësore të OMA (zyrat, pajisjet e zyrave, IT, kancelaritë, telekomunikimin etj.)

- Identifikimin e detajuar të procedurave dhe rregullave të brendëshme duke përfshirë procesin e votimit, vendimet, zbatueshmërinë dhe mbikëqyrjen.
- Hartimin e rregullave dhe rregulloreve me shkrim të OMA të cilat janë në përputhje me ligjin e ri të propozuar të auditimit.
- Zbatimin e një plani biznesi për të përmbushur objektivat dhe qëllimet që lidhen me qëndrueshmërinë e OMA.

Ky veprim do të mbështesë gjithashtu mbikëqyrjen e pavarur të vazhdueshme dhe afat-gjatë të profesionit të auditimit nëpërmjet:

- Sigurimit të ekspertizës ndërkombëtare për të ndihmuar OMA për një periudhë kohe.
- Trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm në monitorimin e cilësisë së funksionit të auditimit.
- Vendosjes së marrëdhënieve me organe të ngjashme mbikëqyrëse në BE për të bërë të mundur fitimin e eksperiencës.
- Zhvillimit dhe zbatimit të një strategjie për të siguruar qëndrueshmërine e OMA në bazë të eksperiencës së vendeve me madhësi të ngjashme në BE (p.sh., Estonia, Letonia, Lituania, Sllovenia).

Ky aktivitet do të marrë në konsideratë punën dhe prononcimet/deklaratat e Grupit Europian të Organeve Mbikëqyrëse (EGAOB).

Rezultati

Ngritja e OMA do të ndihmojë që të sigurohen rregullatorët, investitorët dhe publiku në përgjithësi që llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të audituara japin një informacion të besueshëm mbi gjendjen financiare dhe performancën e një shoqërie.

Programi mbështetës do të sigurojë që OMA do të zhvillohet si një organizim efikas dhe efiçent i aftë për përmbushjen e mandatit të tij legjislativ përveç forcimit të strukturës rregullatore të profesionit të auditimit në Shqipëri në një afat më të gjatë. Mbikëqyrja efikase publike e auditimit është një element shumë i rëndësishëm në ruajtjen dhe rritjen e besimit në funksionin e auditimit.

Së fundmi, ky veprim do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive dhe eksperiencën e brendëshme të cilat do ti japin OMA mundësinë për realizimin e mbikëqyrjes së profesionit të auditimit në Shqipëri në një mënyrë efikase dhe efiçente dhe mbi një bazë të vijueshme afat-gjatë.

Grupet Kryesore të Interesit

- Komiteti i Zbatimit të Projektit (Komiteti Kombëtar Drejtues)
- Ministria e Financës
- Organi Mbikqyres Auditimit

4.1.4 Aktiviteti 4: Forcimi i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet këtij dokumenti te politikave dhe plan veprimi.
Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

Kuadri i kontabilitetit kërkon një Këshill Kombëtar Kontabiliteti të fortë dhe të zgjeruar, të aftë për përmbushjen e kërkesave rregullatore dhe atyre për hartimin/vendosjen e standardeve për profesionin e kontabilitetit.

Përshkrimi

Përmirësimi i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit për të bërë të mundur rritjen e numrit të aktiviteteve duke përfshirë:

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

- Azhornimi i vazhdueshëm i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit

Monitorimi i profesionit të kontabilitetit

- Të nxitet zbatimi i standardeve të larta profesionale në ushtrimin e profesionit të kontabilitetit;
- Të monitorohet zbatimi i dispozitave të ligjit dhe rregulloreve;
- Të monitorohen veprimtaritë e organizatave profesionale të kontabilitetit në lidhje me arsimimin, sistemin e sigurimit/kontrollit të cilësisë dhe etikën profesionale.

Vendosja e marrëdhënieve të jashtëme

- Të përgtatitet një "Memorandum Mirëkuptimi" me partnerët kryesorë rregullatorë të tillë si Qendra e kurikulave, Organi i propozuar për Mbikëqyrjen e Auditimit, Banka Qëndrore, Autoriteti Mbikëqyrës Financiar, Autoritetet Tatimore dhe MF.
- Të punohet me ISAB, hartuesit e standardeve kombëtare dhe institucione përkatëse të BE-së për të nxitur rritjen e cilësisë dhe adaptimin e standardeve të IASB në BE.

Përkthimi dhe adaptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit

- Zgjidhja e çështjeve urgjente që lidhen me zbatimin e SNRF në Shqipëri;
- Mbështetja e trajnimit dhe zhvillimit të burimeve për një qëndrueshmëri dhe zhvillim afatgjatë të këtij funksioni.
- Formalizimi i marrëveshjeve për përkthimin e SNRF-ve në Shqipëri mes palëve përkatëse (Ministria e Financës, Fondacioni i Komitetit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASCF) dhe palë të tjera të përfshira).

Rezultati

Forcimi i kuadrit institucional të profesionit të kontabilitetit nëpërmjet transformimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit duke bërë të mundur që Këshilli të zgjerojë aktivitetet e tij dhe të bëhet një hartues standardesh dhe rregullator i profesionit të kontabilitetit.

Grupet Kryesore të Interesit

- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
- Komiteti i Zbatimit të Projektit (Komiteti Kombëtar Drejtues)
- Ministria e Financës

4.2 Shtylla Kryesore 2: Forcimi i Kapaciteteve Institucionale:

4.2.1 Aktiviteti 1: Banka Qëndrore: Zbatimi i SNRF në sektorin Bankar

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet këtij dokumenti te politikave dhe plan veprimi.
Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

Paraqitja e një programi mbështetës, trajnimi dhe kualifikimi për zbatimin e detyrueshëm të standardeve të auditimit dhe kontabilitetit nga rregullatorët kryesorë (Banka Qëndrore).

Përshkrimi

Mbështetje ndaj Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën Qëndrore për:

- Të siguruar vijueshmëri dhe parashikueshmëri në kuadrin ligjislativ që lidhet me raportimin financiar të bankave dhe legjislacionet e tjera parësore të kontabilitetit dhe auditimit që lidhen me Veprimin 1

- Të organizuar marrëdhënien mes "kapitalit kontabël" dhe "kapitalit të kujdesit" (prudencial) si dhe çështje të tjera kyçe të kontabilitetit të kujdesit dhe të kontabilitetit për qëllime të përgjithëshme. Në këtë kontekst, KKD do të marrë në konsideratë (i) udhëzimet mbi një kuadër të përbashkët raportimi (COREP)[14] që do të përdoret nga institucionet kreditore dhe firmat investuese kur ato raportojnë pranë autoriteteve mbikëqyrëse mbi treguesin (raportin) e aftësisë për të shlyer detyrimet, sipas Direktvës mbi Kërkesat e Kapitalit, dhe (ii) udhëzimeve që përcaktojnë kuadrin e standartizuar të raportimit financiar për qëllime të përgjithëshme (FINREP[15]) për institucionet kreditore në BE.

[14] Udhëzimet mund të gejnden në faqen http://ëëë.c-ebs.org/standards.htm.
[15] Ky kuadër u jep mundësinë institucioneve kreditore të përdorin të njëjtat formate të dhënash dhe përkufizime të dhënash të standardizuara për raportimin për qëllime të kujdesit në të gjitha vendet ku zbatohet kuadri, duke ulur kështu ngarkesën e raportimit për institucionet kreditore që operojnë jashtë kufijve, dhe zvogëlojnë pengesat për zhvillimin e një tregu efikas të brendshëm në shërbimet financiare.

- Të rishikuar "planin e llogarive" të bërë të detyrueshëm nga Banka Qëndrore me qëllim që të sigurohet përputhshmëria me Direktivën për Llogaritë e Bankave (86/635/EEC). Në këtë kontekst, KKD do të marrë në konsideratë zhvillimet e kohëve të fundit në fushën e raportimit financiar (p.sh, FINREP) në vend që të vendoset një listë e detyrueshme llogarish, e cila do të rriste kostot e përputhmërisë për bankat e huaja dhe do të ulte ciësinë e raportimit në krahasim me FINREP. CEBS[16] është e mendimit se Gjuha e Zgjeruar e Raportimi të Biznesit (eXtensible Business Reporting Language (XBRL))— është një instrument më i dobishëm sesa një-plan llogarish- në krijimin e një sistemi raportimi të standardizuar[17].

- Të azhornuar manualin e llogarive të bankave në përputhje me kërkesat e legjislacionit, kërkesat e SNRF-ve dhe kërkesat specifike për qëllime të kujdesit të Bankës Qëndrore. Kjo duhet të ndodhë në mënyrë paralele me rishikimin e "planit të llogarive." Banka Qëndrore duhet të nxjerrë udhëzime në lidhje me kërkesat për njohjen, matjen dhe shpjegimet plotësuese (publikimet) që aplikohen nga bankat tregëtare. Ky aktivitet do të përfshijë gjithashtu krijimin e një procesi brenda Bankës Qendrore për të siguruar që manuali i bankave përditësohet për të pasqyruar ndryshimet në SNRF dhe kërkesat e kujdesit;
- Të organizuar marrëdhënien mes mbikëqyrësve të bankave, audituesit statutorë dhe bankave tregëtare në përputhje me Deklaratën e Praktikës Ndërkombëtare të Auditimit (IAPS) 1004, *Marrëdhënia mes Mbikëqyrësve të Bankave dhe Audituesvee të Jashtëm të Bankave.*[18]
- Të marrë në konsiderate prononcimet/deklaratat e vazhdueshme të CEBS, Komitetit të Mbikëqyrjes e Bankave në Basel,[19] IFAC, dhe IASB.
- Të punuar me planet ekzistuese kontabile në sektorin bankar me qëllim që të sigurohet përputhshmëria me SNRF.

Rezultati

Forcohet stabiliteti i sektorit bankar nëpërmjet një kombinimi të balancuar të mbikëqyrjes së kujdesshme nga njëra anë dhe nxitësve të tregut nga ana tjetër, në përputhje me tre boshtet e

[16] Komiteti Evropian i Mbikëqyrësve Bankare (CEBS) këshillon Bashkimin Evropian mbi çështjet e politikave dhe inkurajon konvergjencën e praktikës së mbikëqyrjes në Bashkimin Evropian. Komiteti gjithashtu mbështet dhe rishikon zbatimin dhe aplikimin e vijueshëm të legjislacionit të Komunitetit.

[17] XBRL është një gjuhë për komunikim elektronik në biznes dhe financë. Ai është një standard i hapur, pa tarfia licensash, i hartuar nga një konsortium ndërkombëtar jo-fitimprurës.

[18] IAPS 1004 u përgatit nga Komitetit Ndërkombëtar i Praktikave të Auditimit (IAPC) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve, dhe u miratua me anë të publikimit nga Komiteti i Mbikëqyrjes së Bankave në Basel dhe IAPC.

[19] Komiteti i Mbikëqyrjes së Bankave në Basel (BCBS) organizon një forum për bahkëpunim të rregullt për sa i takon çështjeve të mbikëqyrjes bankare. Vitet e fundit, ai është shndërruar në një organ për hartimin/vendosjen e standardeve në të gjitha aspektet e mbikëqyrjes bankare, duke përfshirë edhe kuadrin rregullator të kapitalit, Basel II.

Basel II: (1) kërkesat minimale të kapitalit, (2) rishikimi mbikëqyrës të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe (3) informimi publik. Ky veprim do të forcojë gjithashtu edhe rolin e sektorit bankar si "motor" i rritjes ekonomike duke lehtësuar ndërmjetësinë bankare.

Grupet Kryesore të Interesit

- Banka Qendrore
- Komiteti i Zbatimit të Projektit (Komiteti Kombëtar Drejtues)
- Ministria e Financës

4.2.2 Aktiviteti 2: Autoritetet Tatimore: Përdorimi i NAS dhe SNRF-ve për Raportimin e Tatimeve

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet këtij dokumenti politikash dhe plan veprimi.
Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

Prezantimi i një programi mbështetës, trajnimi dhe kualifikimi për zbatimin e detyrueshëm të standardeve të auditimit dhe kontabilitetit nga rregullatorët dytësorë (Organet Tatimore).

Përshkrimi

Të asistohen Autoritetet Tatimore në sigurimin e një baze tatimore efikase dhe të parashikueshme dhe në krijimin e një procesi efikas të vlerësimit tatimor duke ulur koston e shoqërive për arritjen përputhshmërisë, nëpërmjet:

- Asistencës teknike për Autoritetin Tatimore duke përfshirë:
  - Përgatitjen e formularëve të raportimit të tatimeve, rakordimin e bazës të tatimit mbi të ardhurat të korporatës me të ardhurat/humbjet neto të raportuara në llogaritë vjetore.
  - Zhvillimin e politikave formale për zbatueshmërinë dhe procedurave të monitorimit
- Trajnimit mbi SKK dhe SNRF për organet që merren me të ardhurat

- Mbështetjes për vendosjen e një ure tatimore mes Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, SNRF dhe raportimit për qëllime fiskale
- Investigimit të raportimit për qëllime tatimore për përdoruesit që nuk aplikojnë SNRF: Pronarët dhe drejtuesit e shoqërive synojnë të minimizojnë detyrimet fiskale, dhe kjo bën që mbi kontabilistët dhe audituesit të ushtrohet një presion me qëllim që ata të influencojnë në rezultatet e raportuara të llogarive vjetore. Kjo dukuri ndeshet më shumë në shoqëritë e vogla, për të cilat mund të kërkohet një mënyrë e veçantë për tatimin e korporatave për shoqëritë e vogla.

Rezultati

Krjimi i një kuadri ligjor që siguron një bazë tatimore efikase dhe të parashikueshme në hartimin e një procesi efikas të vlerësimit tatimor duke pakësuar koston e shoqërive për arritjen e përputhshmërisë. Raportimi për qëllime fiskale në Shqipëri aktualisht përdor një pjesë të konsiderueshme të aftësive (kapaciteteve) kontabiliste në vend. Përdorimi i burimeve vetëm për të sqaruar dhe për të bashkërenduar mjediset e raportimit financiar dhe tatimor do të kontribuojë në mënyrë të ndjeshme në rëndësinë e përgjithshme që i jepet raportimit financiar në Shqipëri, duke çuar kështu në përmirësim të raportimit financiar në periudhë afat-gjatë.

Grupet Kryesore të Interesit

- Autoritetet Tatimore
- Komiteti i Zbatimit të Projektit (Komiteti Kombëtar Drejtues)
- Ministria e Financës

4.2.3 Aktiviteti 3: Autoriteti I Shërbimeve Financiare: Zbatimi i SNRF në sektorin e sigurimeve dhe tregjet e kapitaleve

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet këtij dokumenti te politikave dhe plan veprimi. Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

Prezantimi i një programi mbështetës, trajnimi dhe kualifikimi mbi zbatimin e detyrueshëm të standardeve të kontabilitetit dhe auditimit nga të gjithë rregullatorët dytësorë (Autoritetet e Shërbimeve Financiare).

Përshkrimi

Mbështetja e Autoritetit të Shërbimeve Financiare (ASHF) për të ndihmuar Shqipërinë në arritjen e përputhshmërisë me pjesët përkatëse të *acquis communautaire* (kuadrit ligjor të BE-së) që lidhen me raportimin financiar në sektorin e sigurimeve dhe pensioneve dhe për të arritur përputhshmërinë me legjislacione të tjera të lidhura të vendit

Gjithashtu, me anë të këtij veprimi do të asistohet ASHF në zhvillimin dhe forcimin e tij për të mbështetur zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe auditimit në këta sektorë kyçë. Në këtë veprim përfshihen:

- Rishikimi dhe amendimi i të gjitha legjislacioneve për të siguruar që kërkesat e raportimit financiar janë në përputhje me *acquis communautaire* në mënyrë të veçantë me **Direktivën për Llogaritë e Sigurimeve (91/674/EEC).**
- Monitorimi i rishikimit të ligjit të BE-së për sigurimet, i hartuar për të rritur mbrojtjen e konsumatorit, modernizimin e mbikëyrjes, për të thelluar integrimin e tregut dhe për të rritur konkurencën ndërkombëtare të siguruesve Evropianë. Sipas sistemit të ri, të njohur si 'Solvency II', siguruesit do të duhet të marrin në konsideratë të gjitha llojet e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohen dhe ti menaxhojnë ato rreziqe me më shumë efikasitet. Gjithashtu, *grupet* e sigurimeve (shoqërive të sigurimeve) duhet të kenë një "mbikëqyrës grupi" të dedikuar, i cili do të mundësonte monitorimin e grupit në tërësi. Komisioni synon të vërë në zbatim sistemin e ri në vitin 2012. Ky propozim është pjesë e strategjisë së Komisionit për një Rregullim më të Mirë dhe angazhimi i tij është të thjeshtojë mjedisin rregullator dhe të eliminojë burokracinë. Kjo nënkupton zëvendësimin e 14 direktivave ekzistuese me një direktive të vetme. Propozimi tashmë i kalon Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për tu marrë në konsideratë (miratim).
- Rishikimi i rregullave mbi mjaftueshmërinë e kapitalit dhe aftësisë për shlyerjen e detyrimeve për të siguruar që legjislacioni dhe rregulloret përcaktojnë parime të përshtatëshme për të mbeshtetur regjimet e aftësisë për shlyerjen e detyrimeve për siguruesit. Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve përcakton tre parime në lidhje me aftësinë për shlyerjen e detyrimeve:
    - Parimi 6 – Regjimet e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë për shlyerjen e detyrimeve duhet të jenë të ndjeshme ndaj rrezikut;
    - Parimi 7 – Një nivel kontrolli është i nevojshëm;

- Parimi 8 – Duhet të specifikohet një shkallë minimale kapitali;

- Rishikimi i kompetencave Mbikëqyrëse për të përcaktuar mundësinë e ASHF për të përshtatur nivelet minimale dhe ato të kontrollit të aftësisë për shlyerjen e detyrimeve, si në aspektin e industrisë (sektorit) në tërësi ashtu edhe në aspektin specifik të kompanive të sigurimit (siguruesit), si dhe në një aspekt kohor të vazhdueshëm. (Në disa juridikisone/territore nivelet minimale dhe ato të kontrollit janë të përcaktuara me legjislacion, ndërsa në juridiksionet e tjera mbikëqyrësi ka kompetencë të vendosë kërkesa alternative për aftësinë për shlyerjen e detyrimeve);
- Ndihma në zhvillimin e strukturave për rishikimin vjetor të kërkesave të legjislacionit Evropian që lidhen me raportimin financiar për sektorin e sigurimeve.

Përveç këtyre, ky veprim do të mbështesë ASHF në vendosjen e rregullave dhe praktikës më të mirë në:

- Kërkesat për licensim – përcaktimin dhe monitorimin e vlerës minimale të kapitalit të kërkuar për të pasur të drejtën e marrjes së liçensës për ushtrimin e biznesit të sigurimeve në territorin (juridiksionin) e Shqipërisë (duke përfshirë faktin që mund të vendoset një nivel më vete kontrolli për shoqëritë e reja të sigurimit me qëllim që të sigurohet një rritje e biznesit të ri ose për rreziqe të tjera që lidhen me planet e tyre operative (të biznesit);
- Rezervat –duke përfshirë përcaktimin nëse profilet individuale të rrezikut të Siguruesve duhet të vlerësohen në nivelin e kontrollit të aftësisë për shlyerjen e detyrimeve të aplikuar për industrinë, ose të aplikohet një nivel më i lartë, p.sh mund të ketë shqetësime të mbikëqyrjes që nuk lidhen me kapitalin e një siguruesi (shoqëri sigurimi) të cilat mund të bëjnë që mbikëqyrësi të kërkojë një nivel më të lartë të aftësisë për shlyerjen e detyrimeve deri në zgjidhjen e problemit;
- Forcimin e aftësive dhe kapaciteteve të stafit aktual të autoritetit rregullator për ngritjen e ekspertizës në aspektin e kërkesave specifike të shoqërive të sigurimit duke përfshirë:
    - Trekëndëzimi i humbjes (metodat të cilat paraqesin modele për zhvillimin e humbjes në bazë të të dhënave historike të sistemuara në formën e trekëndëshave të zhvillimit të humbjes minimale;
    - Përcaktimin e rezervave për humbjet;
    - Përzgjedhjet aktuariale duke përfshirë kujdesin e standardeve të kontabilitetit dhe aktuariale;
    - Vlerësimin e Pretendimeve (kërkesave) të Kryera por të Pa-Raportuara (IBNR);
    - Praktikat dhe procedurat e përdorura për llogaritjen e rezervave të primeve të pa-përfituara (UEPR);

- Një program për trajnimin e rregullatorëve mbi impaktin e SNRF[20] në sektorin e sigurimeve dhe në veçanti në kërkesat specifike të raportimit të shoqërive të sigurimeve.
- Zhvillimin/përgatitjen e udhëzuesve për sektorin e sigurimeve për zbatimin e SNRF.
- Organizimin/vendosjen e marrëdhënieve mes mbikëqyrësve të siguruesve (shoqërive të sigurimit), audituesve statutorë dhe shoqërive të sigurimeve duke transmetuar parimet e përcaktuara në IAPS 1004, *Marrëdhëniet mes Mbikëqyrësve të Bankave dhe Audituesve të Jashtëm të Bankave*.

Ky aktivitet duhet të marrë në konsideratë prononcimet e vazhdueshme të Komitetit të Sigurimeve Evropiane dhe Supervizorëve të Pensioneve Profesionale (CEIOPS),[21] Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS),[22] IFAC, dhe IASB.

Së fundmi, ky aktivitet do të marrë në konsideratë një plan veprimi për të trajtuar nevojën për rregullim dhe forcim të tregut të aksioneve dhe të bursës.

Rezultati

Krijimi i një kuadri të qëndrueshëm legjislativ dhe rregullator i cili mbështet një mjedis bashkëkohor raportimi për industrinë e sigurimeve në përputhje me *acquis communautaire* dhe zhvillimin e një rregullatori të shërbimeve financiare të aftë për të monitoruar dhe siguruar përputhshmërinë me legjislacionin dhe rregulloret për raportimin financiar për sipërmarrjet/shoqëritë e sigurimit

Grupet Kryesore të Interesit

- Autoritetet e Shërbimeve Financiare
- Komiteti i Zbatimit të Projektit (Komitetit Drejtues Kombëtar)
- Ministria e Financës

---

[20] Ndonëse ky raport në përgjithësi rekomandon zbatimin e SNRF, është e ditur se zbatimi i tij në fushën e sigurimeve është akoma në diskutim. Për shkak të burimeve të pakëta në vend, dhe duke qenë se IASB është ende në procesin e finalizimit të standardeve specifike për kontabilitetin e sektorit të sogurimeve (të parashikuara për në vitin 2009), ky raport rekomandon që Shqipëria të vëzhgojë se çfarë do të vendosë BE e EU para adaptimit të SNRF-ve të plota në industrinë e sigurimeve. Ndërkohë, Direktiva mbi Llogaritë e Sigurimeve dhe përshtatjet përkatëse të bëra nga vende anëtare në transpozimin e saj do të ishte një pike referimi e përshatëshme.

[21] CEIOPS përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë nga autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve dhe pensioneve profesionale të vendeve anëtare të BE-së.

[22] IAIS përfaqëson rregullatorë dhe mbikëqyrës të sigurimeve të afro 180 juridiksioneve dhe nxjerr parime globale të sigurimeve, standarde dhe dokumenta udhëzuese, ofron trainime dhe mbështetje për çështjet që lidhen me mbikëqyrjen e sigurimeve dhe organizon takime dhe seminare për mbikëqyrësit e sigurimeve.

4.2.4 Aktiviteti 4: Qëndra Kombëtare e rregjistrimit: Implementimi i Depozitimit Elektronik Efikas të Pasqyrave Financiare të Kompanive

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet këtij dokumenti te politikave dhe plan veprimi. Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe efiçent depozitimi dhe publikimi (të pasqyrave financiare) në Shqipëri në përputhje me pjesët përkatëse të *acquis communautaire*[23] dhe duke marrë në konsideratë kërkesat për shoqëritë në lidhje me depozitimin në vendet e tjera.

Përshkrimi

Qendra Kombëtare e Regjistrimit [24] do të kërkojë mbështetje të vazhdueshme për të siguruar depozitimin dhe publikimin nga të gjitha shoqëritë duke ndjekur praktikat më të mira ndërkombëtare duke përfshirë:

- Sigurimi i një kuadri legjislativ me baza të forta dhe të qëndrueshëm për depozitimin dhe publikimin e pasqyrave financiare të shoqërive në Shqipëri.
- Direktiva 2003/58/KE që amendon Direktivën e Parë të Ligjit për Shoqëritë Tregëtare kërkon publikimin e pasqyrave financiare nga shoqëritë në formë elektronike pasi kjo lehtëson mundësinë e pajisjes së publikut me informacion mbi shoqëritë dhe thjeshton formalitetet e dhënies së shpjegimeve/publikimeve për shoqëritë.
  Sipas kësaj direktive kërkohet gjithashtu që vendet anëtare të parashikojnë për vendosjen e masave të duhura ndëshkuese për rastet kur shoqëritë nuk sigurojnë përputhshmëri[25]. Gjithashtu, për shoqëritë e listuara (për momentin asnjë në Shqipëri) Direktiva e

---

[23] Direktiva e Parë e Ligjit për Shoqëritë Tregëtare (68/151/EEC), Direktiva e Katërt mbi Llogaritë Vjetore (78/660/EEC), dhe Direktiva e Shtatë mbi Llogaritë e Konsoliduara (83/349/EEC) aplikohen për të gjitha shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Ato përcaktojnë parimin për shpjegimet sqaruese/publikimet e detyrueshme. Direktiva për Transparencën (2004/109/EC) përcakton kërkesat minimale të transparencës për shoqëritë e listuara, duke rritur cilësinë e informacionit të disponueshëm për të informuar investuesit mbi performancën dhe gjendjen financiare të shoqërive.

[24] QKR (ëëë.qkr.gov.al) me anë të procedurave të regjistrimit elektronik po punon për të bërë të mundur që Regjistri Tregëtar në Shqipëri dhe regjistrimi i bizneseve të jetë plotësisht në linjë me standardet ndërkombëtare. Regjistri i ri i Gjykatës është plotësisht në përputhje me Direktivat e aplikueshme të BE dhe do të bëjë të mmundur që informacioni i Regjistrit Tregëtar të jetë plotësisht i aksesueshëm nga partnerë të hauj biznesi si dhe nga përdoruesit vendas.

[25] Në mënyrë të veçantë, KKD do të sigurojë që Shqipëria ekzaminon zbatimin praktik të kërkesës për vënien në dispozicion, nga një datë jo më vonë se 1 janar 2007, në letër ose formë elektronike, sipas zgjedhjes së aplikuesit, të dokumentave sqaruese të specifikuara nga lloje të caktuara shoqërish.

Transparencës[26] përcakton parimin e publikimit të detyrueshëm të informacionit financiar dhe informacioneve të tjera nga këto shoqëri.

- Publikimi mund të bëhet në tre forma: së pari, hapja e një dosje për çdo shoqëri në një regjistër zyrtar; së dyti publikimi në një gazetë zyrtare kombëtare; dhe së treti, në të gjitha dokumentat e biznesit të ketë një tregues të formës ligjore dhe vendndodhjes së regjistrimit të biznesit të shoqërisë dhe regjistri ku mbahet dosja për shoqërinë, së bashku me numrin e shoqërisë në atë regjistër.
- Të përcaktohen kërkesat minimale të transparences për Njësitë me Interes Publik. KKD ka marrë në konsideratë kërkesat për publikim (dhe shpjegime) të përcaktuara në Direktivën për Transparencën, të cilat plotësojnë një paketë të masave të BE-së për Planin e Veprimit për Shërbimet Financiare, duke përfshirë Rregulloren 1606/2002.
- Të vendosen masa parandaluese (p.sh, sanksione) për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat për depozitim të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara.

Ky veprim do të përfshijë sa më poshtë:

- Ndihmën në pajisjen e QKR me sisteme dhe teknologji për depozitimin dhe publikimin e informacionit financiar. Këto sisteme duhet:
    - Të lehtësojnë mbledhjen e raporteve vjetore dhe raporteve vjetore të konsoliduara në mënyrë elektronike.
    - Të bëjnë të mundur ruajtjen e raporteve vjetore dhe raporteve të konsoliduara vjetore për periudha të caktuara kohore në përputhje me kërkesat e BE-së.
    - Të bëjnë të mundur aksesin në formë elektronike tek raportet vjetore dhe raportet vjetore të konsoliduara
    - Të mbështesin monitorimin e përputhshmërisë me kërkesat legjislative për depozitimin e raporteve vjetore dhe raporteve vjetore të konsoliduara
- Mbështetjen për krijimin e një sërë proçedurash dhe kapacitetesh për monitorimin dhe zbatimin e depozitimit të plotë dhe në kohë nga shoqëritë.
- Hartimin dhe zbatimin e një Strategjie Informacioni dhe një rishikim të procesit të biznesit për një QKR Qendror (të kufizuar në aktivitetet e Regjistrit në depozitimin e informacionit të shoqërisë) në përputhje me kërkesat e BE-së për depozitim të raporteve vjetore dhe raporteve vjetore të konsoliduara, duke analizuar përdorimin e mundshëm të XBRL
- Krijimin e kapaciteteve shtesë për forcimin e burimeve të regjistrit dhe për zhvillimin e aktiviteteve të zbatimit të QKR, duke përfshirë marrjen e masave në rastet e shkeljeve të kërkesave për depozitim.

[26] Direktiva për Transparencën për shoqëritë të tregëtuara në mënyrë publike (2004/109/EC): Kjo direktivë përcakton kërkesat minimale për transparencë për shoqëritë e listuara, duke rritur cilësinë e informacionit të disponueshëm për investuesit në lidhje me performancën dhe gjendjen financiare të shoqërive.

Rezultati

Një kuadër i qëndrueshëm legjislativ dhe rregullator për publikimin dhe depozitimin e informacionit financiar në Shqipëri i cili plotëson kërkesat e legjislacionit Evropian dhe inkurajon një kulturë të përputhshmërisë.
Gjithashtu, ky veprim do të kontribuojë për një rritje të ndjeshme të disponueshmërisë së një informacioni financiar cilësor për publikun në Shqipëri i cili:

- Plotëson kërkesat e *acquis communautaire* në lidhje me publikimin dhe depozitimin e informacionit financiar.
- Mbrojtjen e palëve të treta (duke përfshirë kreditorët, furnitorët, punonjësit etj) pasi bërja publike e raporteve vjetore dhe raporteve vjetore të konsoliduara do të zvogëlonte asimetrinë e informacionit mes shoqërisë dhe palëve të treta, duke i bërë këto të fundit më të mbrojtura.
- Mbron publikun nga impakti i mundshëm negativ ekonomik (p.sh në rastin e shoqërive të rëndësishme, ku veprimet dhe/ose largimi i tyre mund të kenë një impakt negativ të ndjeshëm në ekonominë e vendit)
- Inkurajon përmirësimin e efiçiencës alokative si brenda kompanive ashtu edhe në vetë ekonominë në tërësi (p.sh. menaxherët dhe investuesit kanë më shumë mundësi të bëjnë dallimin mes mundësive të mira dhe jo të mira të investimit dhe veprimtarive të biznesit.)

Grupet Kryesore të Interesit

- Qendra Kombëtare e Regjistrimit
- Komiteti i Zbatimit të Projektit (Komiteti Kombëtar Drejtues)
- Ministria e Financës

4.2.5 Aktiviteti 5: Profesioni i Audituesit

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet këtij dokumenti politikash dhe plan veprimi. Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

Zhvillimi i mëtejshëm i IEKA-s në një organ profesional që të arrijë të bëhet një organ plotësisht i aftë për të kryer me sukses detyrat e tij rregulluese lidhur me auditimin që i nënshtrohet mbikqyrjes publike.

Përshkrimi

Të hartohet dhe ofrohet ndihmë për realizimin e një strategjie 5-vjeçare e cila do të bëjë të mundur që Instituti profesional i Auditimit (IEKA) të luajë plotësisht rolin e tij në infrastrukturën Shqiptare të auditimit në linjë me praktikat dhe rregulloret më të mira ndërkombëtare si dhe me kërkesat e anëtarësimit të IFAC.

Dokument politikash duhet të trajtojë, minimalisht, proceset për vijueshmëri duke përfshirë ristrukturimin e Institutit, në mënyrë që të jetë një organizatë që i përgjigjet më shpejt kërkesave; hartimin e një plani biznesi të buxhetuar; shtimin e risive në produkte dhe shërbime duke pasur parasysh mjedisin e ndryshueshëm; si dhe përmirësimin e programeve të tij të marketingut dhe mbështetjes.

Projekti do të mbështesë gjithashtu përmirësimin e sistemit të IEKA-s për monitorimin e cilësisë së anëtarëve të tij duke përfshirë plotësimin e kërkesave për kualifikimin e vazhdueshëm profesional. Për më tepër, do të ofrohet asistencë teknike për të krijuar një mekanizëm i cili do të merret me çështjen e vijueshmërisë duke përfshirë rritjen e sponsorizimeve tregtare dhe aleancave për disa aktivitete.

Projekti do të financojë gjithashtu ndihmën që do të jepet për kryerjen e vlerësimeve periodike të nevojave dhe prioriteteve të anëtarëve të saj dhe përfshirjen e rezultateve të vlerësimit në planifikimin strategjik dhe në programet e trainimit.

Me qëllim që të arrihet ky objektiv, duhet të hartohet një plan veprimi i cili të përfshijë:

- rishikimin e aktiviteteve në mënyrë që të pasqyrojnë rolin e ri më të madh të IEKAs
- një plan për mbështetjen e Sekretariatit;
- një plan për mbështetjen e aftësive teknike të IEKA-s;
- një plan biznesi që të përmbushë objektivat dhe qëllimet që lidhen me qëndrueshmërinë financiare të Institutit
- një strategji të burimeve njerëzore për të arritur qëllimet dhe synimet që lidhen me ekspertizën që i është vënë në dispozicion Institutit;

Profesionet në vend duhet të kenë parasysh udhëzuesin e IFAC-ut me titull '*Krijimi dhe Zhvillimi i një Organi Profesional Kontabiliteti*' dhe të mbulojnë aspektet e mëposhtme kyçe:

Në mënyrë të rëndësishme ky aktivitet do të duhet të përfshijë krijimin e një metodologjie auditimi (elektronike) në pajtim të plotë me SNA-të që të jetë e përshtatshme edhe për auditime të njësive të vogla ekonomike.

Mbështetja Institucionale

Ky veprim do të mbështesë identifikimin dhe projektimin e detajuar të arkitekturës operative të IEKA-s që përfshin:

- Zhvillimin e strukturës organizative në mënyrë që të realizojë një gamë aktivitetesh në pajtim me aktet nënligjore dhe Ligjin e ri të propozuar për Auditimin, që do të përfshijnë:
    - Etikë dhe pavarësi;
    - Arsim / çertifikim;
    - Regjistrim të audituesve;
    - Zhvillim të Vijueshëm Profesional;
    - Kontroll të cilësisë; dhe
    - Disiplinë.
- Rishikimin e strukturës organizative të sekretariatit të IKEA-s
- Hartimin e një plani biznesi të korporatës që të mbulojë objektivat, financimet, strukturat, synimet dhe programin vjetor të veprimtarive sipas objektivave.
- Identifikimin e çdo fushe funksionale.
- Paraqitjen në vija të përgjithshme të masave të marra për raportimin dhe komunikimin si me anëtarët, CAOA-n ashtu edhe me palë të tjera të përfshira të rëndësishme.

Regjistrimi i Audituesve

Për sa i përket **regjistrimit të audituesve** të çertifikuar nga Ministria e Financave, ky aktivitet do të ndihmojë IEKA-n të marrë përsipër këtë përgjegjësi për komisionin aktual të regjistrimeve duke përfshirë:

- Mbështetjen për forcimin e kapaciteteve të IEKA-s për regjistrimin e vijueshëm të audituesve dhe firmave të auditimit statutor në Shqipëri;
- Vënien në dispozicion të ekspertizës ndërkombëtare për të analizuar në mënyrë të pavarur regjistrimin publik dhe përmbajtjen e tij duke pasur parasysh Nenet 15 deri 20 të Direktivës së re të Tetë të BE-së lidhur me Ligjin për Shoqëritë Tregtare; dhe

Ky aktivitet do të bëjë të mundur që IEKA të përmirësojë **programin** e **garantimit** të jashtëm **të cilësisë** që anëtarët të kontrollojnë nëse audituesit statutorë veprojnë në pajtim me parimet themelore të kontrollit të jashtëm të cilësisë duke i kushtuar vëmendjen e duhur:

- Nenit 29 të Direktivës së re të Tetë të BE-së lidhur me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, e cila shtron kërkesën që të gjithë audituesit dhe firmat audituese statutore t'i nënshtrohen sistemit të garantimit të cilësisë;
- Rekomandimit të Komisionit Evropian nxjerrë në Nëntor 2000 lidhur me Garantimin e Cilësisë për Audituesin Statutor në BE; [27]
- Deklaratat e IFAC-ut për Detyrimet e Anëtarësimit Nr 1, *Garantimi i Cilësisë.*[28]

Garantimi i jashtëm i cilësisë

Ky veprim do të mbështesë zbatimin e një regjimi efikas dhe efiçent për kontrollin e jashtëm të cilësisë brenda profesionit të auditimit në Shqipëri duke marrë parasysh si më poshtë:

- Kontrollorët duhet të kenë përvojën dhe kualifikimet e duhura profesionale. Paanshmëria dhe objektiviteti i tyre duhet të jenë të garantuara. Me qëllim që të sigurohet një sistem kontrolli cilësie i besueshëm dhe efikas duhet të caktohen burimet e nevojshme
- Objekti i kontrollit të cilësisë duhet të përfshijë një vlerësim të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë të një firme auditimi me testime të mjaftueshme të shkallës së përputhshmërisë së procedurave dhe dosjeve të auditimit për të verifikuar funksionimin e duhur të tij.
- Rregullat bëjnë dallimin midis metodave të sigurimit të cilësisë, në varësi të faktit nëse audituesit statutorë kanë apo jo si klientë njësi ekonomike me interes publik.

---

[27] Komisioni Evropian ka miratuar Rekomandimin që vendos standardet minimale për sistemet e garantimit të cilësisë nga jashtë për auditimet ligjore në BE. Sistemet e garantimit (sigurimit) të cilësisë nga jashtë janë zhvilluar si një verfikim i cilësisë së auditimeve ligjore. Qëllimi i garantimit të cilësisë është marrja e masave që auditimet ligjore të kryhen në përputhje me standardet e vendosura për auditimet dhe që audituesit të respektojnë rregullat e etikës (përfshirë pavarësinë). Rekomandimi parashtron një paketë të plotë kërkesash minimale për sistemet e garantimit të cilësisë në Shtetet Anëtare të BE-së me qëllim që të jetë e sigurt që të gjithë audituesit ligjorë të jenë të përfshirë në sisteme të njëjta të garantimit të cilësisë me mbikqyrje publike të mjaftueshme dhe rezultate të publikuara.

[28] DDA 1 do të zbatohet nga organet anëtare të IFAC-ut në programet rishikuese për sigurimin/kontrollin e cilësisë për anëtarët e tyre që kryejnë disa angazhime auditimi të pasqyrave financiare. Ajo zbatohet si në rastet kur organet Anëtare i realizojnë këto programe në emër të tyre, në emër të profesionit, apo në emër të qeverive, rregullatorëve apo agjensive të tjera, ashtu edhe kur programet realizohen nga një organ tjetër.

- Për të vlerësuar suksesin e një regjimi të tillë, duhet të përcaktohen qëllime dhe synime specifike të bazuara në praktikat ndërkombëtare në fushën e kontrollit të cilësisë. Minimalisht, regjimi i kontrollit të cilësisë duhet të monitorojë të gjithë audituesit e njësive me interes publik si fillim dhe që këtej të zgjerojë programin e punës.

Investigimi dhe Disiplina

Ky aktivitet do ta ndihmojë IEKA-n në hartimin e një proçedure për ankesat dhe një sistemi disiplinor për anëtarët, në mënyrë që t'i sigurojë si përdoruesit ashtu edhe palët e treta që standardi i punës që kryhet nga audituesit dhe firmat audituese i nënshtrohet parimeve themelore të sigurimit të cilësisë dhe **disiplinës** duke i kushtuar vëmendjen e duhur:

- Nenit 30 të Direktivës së re të Tetë të BE-së lidhur me Ligjin për Shoqëritë Tregtare,

  e cila vendos parimin e përgjithshëm që Shtetet Anëtare duhet të organizojnë sisteme efikase investigimi dhe sanksione efikase e shkurajuese, të cilat mund të jenë civile, administrative apo penale;

- Rekomandimin e Komisionit Evropian nxjerrë në Nëntor 2000 lidhur me Sigurimin e Cilësisë për Audituesin Statutor në BE; dhe

- DDA-së së IFAC-ut Nr. 6, Investigimi dhe Disiplina.

Standardet e auditimit

Përmirësimi i procesit të përditesimit të Standardeve të Auditimit përfshirë:

- Sigurimin e përditesimeve zyrtare të standardeve ndërkombëtare të auditimit.
- Krijimin dhe përdorimin e një fjalori me terma të kontabilitetit në gjuhën shqipe.
- Ngritjen e një komisioni përditesimin të SNA-së për të formalizuar procedurat efiçente dhe efikase.
  - Bërjen të mundur të përgjigjes (përkthimit) së menjëhërshme të volumit të konsiderueshëm të materialeve që duhen përkthyer; dhe
  - Marrjen e masave me qëllim që komisioni i përkthimit të konsultohet me IFAC dhe të plotësojë kërkesat që ka procesi i përkthimit zyrtar.
  - Hartimin dhe zbatimin e një strategjie për të siguruar vazhdimësinë e procesit të përditesimit duke u bazuar në përvojën e vendeve me madhësi të ngjashme në BE (psh. Estonia, Latvia, Lituania dhe Sllovenia).

Metodologjia e auditimit e bazuar në SNA

- Me qëllim që të mbështesë zbatimin e duhur të standardeve të SNA-së për auditimet statutore dhe për të përfituar nga disa ekonomi të shkallës, IEKA duhet të ofrojë një

metodikë auditimi elektronike të standardizuar – plotësisht në pajtim me SNA-e cila është gjithashtu e përshtatshme për auditime të njësive të vogla ekonomike.

Standardet e etikës dhe pavarësisë

Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) vendos dhe nxit zbatimin e standardeve ndërkombëtare të pavarësisë dhe standardeve të tjera profesionale. Si një anëtar i asociuar i IFAC-ut, IEKA duhet, minimalisht, të zbatojë rregullat e kodit të etikës të IFAC-ut dhe t'i përfshijë ato në kodin e IEKA-s. Ky aktivitet duhet të mbështesë këtë objektiv të rëndësishëm.

Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (CPD)

Është e rëndësishme që ky veprim të mbështesë zbatimin e programit të hartuar për **CPD-në** si vijon:

- Të ndihmojë në zbatimin praktik të programit CPD.
- T'i ofrojë ekspertizë IEKA-s në trajnimin e stafit që ky të realizojë programe CPD-je për anëtarët, duke theksuar në mënyrë të veçantë zbatimin praktik të SNRF-së, SNA-së, dhe Kodit të Etikës së IFAC-ut për Kontabilistët Profesionistë.
- Të zhvillojë materiale mësimore lidhur me zbatimin praktik të Kodit të Etikës së SNA-së dhe IFAC-ut për Kontabilistët Profesionistë që të përdoren nga anëtarët e IEKA-s për të formuar bazën e programeve të trajnimit për CPD-në.
- Të koordinohet me institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri për të shqyrtuar mundësitë që kanë institucionet e larta arsimore për të ndihmuar në hartimin e programeve për CPD-në në periudhën afatgjatë.[29]
- Të zbatojë një strategji që siguron vazhdimësinë e procesit CPD të bazuar në përvojat e vendeve me madhësi të ngjashme në BE (psh. Estoni, Latvia, Lituani, Sllloveni).
- Të vërë në dispozicion ekspertizë ndërkombëtare për të matur në mënyrë të pavaruar progresin e IEKA-s në këtë fushë në mënyrë periodike.

Rezultati

Një organ i konsoliduar profesional auditimi me kompetenca dhe burime të mjaftueshme për të ndikuar në cilësinë e auditimit do të çojë në një rritje të cilësisë së raportimit financiar në Shqipëri.

Veprimi do të rrisë efikasitetin e institutit vendor në sigurimin e kushteve për nxitjen e cilësisë së shërbimit të auditimit në Shqipëri. Burimet që nevojiten për të bërë të

[29] Metodat e realizimit të programit të CPD duhet të jenë të hapura ndaj zgjedhjes individuale e t'i nënshtrohen kontrollit të përshtatshëm të cilësisë

mundur përmirësimin e arkitekturës së Institutit vendor dhe të mënyrës së tyre të të vepruarit (*modus operandi)* do të përdoren me efikasitet, nëse arrijnë të mbështesin strukturat që do të bëjë të mundur suksesin e tij në të ardhmen.

Përputhja me Deklaratat e IFAC për Detyrimet e Anëtarësimit (DDA) do të ofrojë standarde/pika referimi të qarta për të ndihmuar Institutin që të sigurojë performancë të një cilësie të lartë nga audituesit profesionistë.
Si rrjedhojë e realizimit të objektivave të parashtruara më lart parashikohet që të arrihet anëtarësimi i plotë i IEKA-s në IFAC.

Grupet Kryesore të Interesit

- IEKA
- Organ i propozuar për Mbikqyrjen e Auditimit
- Komiteti për Zbatimin e Projektit (Komiteti Kombëtar Drejtues)
- Ministria e Financave

4.2.6 Aktiviteti 6: Profesioni i Kontabilistit

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet këtij dokumenti politikash dhe plan veprimi. Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

T'u ofrohet ndihmë organizatave profesionale të kontabilitetit në zhvillimin dhe zbatimin e proceseve dhe procedurave të strukturuara dhe të përmirësuara që do të mundësojnë zhvillimin e një mënyre funksionimi (*modus operandi)* të organizatës që është efikase, efiçente dhe në pajtim me praktikat e mira ndërkombëtare.[30] Qëllimi është të rregullohet siç duhet profesioni i kontabilistit pa dëmtuar konkurrencën dhe të sigurohet mbrojtja e palëve të treta të cilët përftojnë shërbimet e ofruara nga kontabilisti.

[30] Këto procese dhe procedura duhet të jenë në përputhje me Deklaratat e Detyrimeve të Anëtarësimit hartuar nga IFAC dhe praktikat ekzistuese në Shtetet Anëtare të BE-së.

Përshkrimi

Hartimi dhe ndihmesa në realizimin e një strategjie 5-vjeçare do të bëjë të mundur që organizatat profesionale të kontabilitetit të identifikojnë dhe realizojnë qartë një program të përmirësuar aktivitetesh që do të ndihmojnë zhvillimin e një profesioni të besueshëm të kontabilistit.

Dokumenti i politikave duhet të trajtojë, minimalisht, proceset për vijueshmëri duke përfshirë projektimin e instituteve të përzgjedhura në mënyrë efikase; hartimin e një plani biznesi të buxhetuar; shtimin e risive në produktet dhe shërbimet duke pasur parasysh mjedisin e ndryshueshëm; si dhe përmirësimin e programeve të saj të marketingut dhe mbështetjes.

Projekti do të mbështesë gjithashtu përmirësimin e sistemeve të organizatave profesionale të kontabilitetit për monitorimin e cilësisë së anëtarëve të tij duke përfshirë plotësimin e kërkesave për kualifikimin e vazhdueshëm profesional. Për më tepër, do të ofrohet asistencë teknike për të krijuar një mekanizëm që të merret me çështjen e vijueshmërisë duke përfshirë shtimin e sponsorizimeve komerciale dhe aleancave për disa aktivitete. Projekti do të financojë gjithashtu ndihmën që do të jepet për kryerjen e vlerësimeve periodike të nevojave dhe prioriteteve të anëtarëve të tij dhe përfshirjen e rezultateve të vlerësimit në planifikimin strategjik dhe programet e trajnimit.

Me qëllim që të arrihet ky objektiv, duhet të rishikohen aftësitë e organizatave profesionale dhe të hartohet një plan i cili të përfshijë:

- një plan që të mbështesë sekretariatin;
- një plan që të mbështesë aftësitë teknike të organeve profesionale të kontabilitetit
- një plan biznesi që të arrijë qëllimet dhe synimet që lidhen me qëndrueshmërinë financiare të organeve profesionale të kontabilitetit
- një strategji e burimeve njerëzore për të arritur qëllime dhe synime që lidhen me ekspertizën që i është vënë në dispozicion organeve profesionale të kontabilitetit;

Organizatat profesionale të kontabilitetit duhet të kenë parasysh udhëzuesin e IFAC-it me titull *Krijimi dhe Zhvillimi i një Organi Profesional Kontabiliteti*

Rezultati

Organet e fuqizuara profesionale të kontabilitetit do të kontribuojnë ndjeshëm në cilësinë e raportimit financiar në Shqipëri. Aktivitetet do të forcojnë besueshmërinë e raportimit financiar në Shqipëri dhe do të ndihmojnë në formalizimin e ekonomisë informale duke nxitur kështu rritjen ekonomike.

Grupet Kryesore të Interesit

- Organizatat Profesionale të Kontabilitetit
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
- Komiteti për Zbatimin e Projektit (Komiteti Kombëtar Drejtues)
- Ministria e Financave

4.2.7 Aktiviteti 7: Sektori i Universiteteve

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet këtij dokumenti te politikave dhe plan veprimi. Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

Të përmirësohet niveli i programit mësimor të SNRF dhe SNA-së për modulet e kontabilitetit që zhvillohen brenda institucioneve të nivelit të tretë (psh. universitetet) duke pasur si qëllim final përmirësimin e cilësisë së të diplomuarve për kontabilitet dhe rritjen e shkallës së të kuptuarit të përgjithshëm të kontabilitetit nga ana e të diplomuarve të degëve të tjera, si *për shembull*, studentët e juridikut.
Programi mësimor për kontabilitetin dhe auditimin duhet të pasqyrojë ndryshimet e rëndësishme në kuadrin e kontabilitetit dhe auditimit të këtyre viteve të fundit.

Të rritet shkalla e përgatitjes së pedagogëve të universitetit, lektorëve dhe palëve të tjera të përfshira në mësimdhënien e kontabilitetit dhe auditimit, me qëllim që të hartojnë dhe zhvillojnë kurse të reja e bashkëkohore të cilat do të përdorin dhe zbatojnë SNRF dhe SNA-në.

Përshkrimi

Realizimi i veprimtarive që përfshijnë:

- Krijimin e një komiteti këshillues që të punojë me ministritë dhe universitetet përkatëse dhe që të përfaqësojë qëndrimet e të gjithë palëve të tjera kyçe të përfshira (psh përgatitësit,

rregullatorët, përdoruesit dhe audituesit e llogarive vjetore dhe të konsoliduara) për të hartuar dhe përmirësuar programin mësimor të moduleve të kontabilitetit, siç zhvillohet nga të gjitha institucionet arsimore përkatëse, në pajtim me nevojat e një ekonomie moderne të tregut.

- Hartimin, fillimin dhe vendosjen e një programi të udhëhequr nga një universitet i njohur botërisht për të realizuar programin e vendosur nga komiteti këshillues.
- Hartimin dhe zbatimin e një strategjie për përmirësimin e cilësisë dhe disponueshmërisë së teksteve shkollore, rasteve studimore (ushtrimeve) dhe materialeve të tjera të trajnimit mbi SNA dhe SNRF, që aktualisht janë të pamjaftueshme, sidomos për sa i përket zbatimit të standardeve në praktikë.

Rezultati

Raportimi financiar i korporatës luan një rol vendimtar në një ekonomi bashkëkohore tregu që funksionon mirë. Është e rëndësishme që publiku i gjerë dhe studentët e nivelit të tretë ta kuptojnë këtë realitet. Të kuptuarit e këtij realiteti realizohet me anë të një programi të fortë mësimor për kontabilitetin dhe auditimin në nivelin e tretë të arsimit në Shqipëri.

Kjo është e rëndësishme jo vetëm në mënyrë të drejtëpërdrejtë për studentët e kontabilitetit por edhe për degët e tjera (psh, administrim biznesi, drejtësi, ekonomiks) për të siguruar që të gjithë sektorët e një ekonomie që funksionon të mund të marrin vendime të mirëinformuara të bazuara në të dhëna financiare të besueshme.

Burimet që kërkohen për të filluar një program me veprimtari që çojnë në ngritjen e nivelit të programit mësimor të kontabilitetit do të çojnë në një përmirësim të njohurive të atyre që futen në programet e trajnimeve në fushën e auditimit në periudhën afatgjatë.

Me rëndësi gjithashtu është edhe fakti që njohuritë e thelluara të të gjithë studentëve të nivelit të tretë që kanë zgjedhur e ndjekin modulin e kontabilitetit do të ndikojnë në zgjerimin e bazës së njohurive të përgjithshme në lidhje me rëndësinë e një raportimi të mirë financiar të korporatës.

Grupet Kryesore të Interesit

- Universitetet
- Qendra e Kurikulave
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
- Komiteti për Zbatimin e Projektit (Komiteti Kombëtar Drejtues)
- Ministria e Financave

4.3 Shtylla Kryesore 3: Rritja e Ndërgjegjësimit për Raportimin Financiar të Korporatës

4.3.1 Aktiviteti 1: Fushata për Ndërgjegjësimin e Publikut në lidhje me Ekonominë Informale dhe Përfitimet e Kontabilitetit dhe Auditimit

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet këtij dokumenti te politikave dhe plan veprimi. Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

Një program për ndërgjegjësimin e publikut i hartuar dhe zbatuar në mënyrën e duhur që të çojë në rritjen e kërkesës së publikut për një raportim të mirë financiar të korporatës

Përshkrimi

Për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe besimin në raportimin financiar në Shqipëri, palëve të ndryshme të përfshira duhet t'u ofrohet ndihmë, në mënyrë që të bëhet e mundur që programi për ndërgjegjësimin publik të përfshijë:

- Identifikimin e 50 opinionistëve, drejtuesve dhe menaxherëve të rëndësishëm në Shqipëri dhe organizimin e seminareve për të informuar këtë grup të rëndësishëm mbi dëmin që sjell ekonomia joformale.
- Identifikimin e 50 drejtuesve dhe menaxherëve të rëndësishëm në ekonominë shqiptare dhe organizimin e seminareve për të bërë të njohura kërkesat për auditim statutuor dhe vlerën e tij
- Identifikimin e 50 drejtuesve dhe menaxherëve të rëndësishëm në ekonominë shqiptare dhe organizimin e seminareve për të bërë të njohura avantazhet financiare të një kulture të fortë të respektimit të rregullave dhe standarteve;
- Rritjen e ndërgjegjësimit publik në lidhje me avantazhet e raportimit të mirë të korporatës.
- Nxitjen e ndërgjegjësimit publik në lidhje me integritetin, objektivitetin, kompetencën, dhe profesionalizmin e audituesve dhe palëve kyçe të përfshira;
- Dhënien e informacionit, udhëzimit për arsimimin dhe asistencës teknike publikut; dhe

- Nxitjen e publikimit të informacionit dhe transparencës për sa i përket raportimit financiar të korporatës.

Në mënyrë më specifike, fushatat ndërgjegjësuese mund të përqendrohen në:

- Për manaxherët – tërheqjen e vëmendjes ndaj një kulture komunikimi të ndershme dhe të hapur, duke e ripërqëndruar auditimin e brendshëm në çështje të mëdha dhe që paraqesin më shumë rrezik dhe duke nxitur gjetjen e një rrugë të sigurt që punonjësit të komunikojnë shqetësime serioze (të sinjalizojnë); dhe
- Për drejtorët – tërheqjen e vëmendjes ndaj arritjes së një shkalle më të lartë kuptueshmërie të biznesit, duke e përdorur atë shkallë kuptueshmërie për të sfiduar në mënyrë më të informuar dhe konstruktive stafin manaxhues, duke ushtruar të drejtën e aksesit të informacionit nëpërmjet audituesve të brendshëm dhe të jashtëm.

Rezultati

Nxitja e ndërgjegjësimit në lidhje me publikimin e informacionit dhe transparencën e korporatës në lidhje me raportimin financiar në periudhën afatgjatë do të çojë në:

- Rritje të besimit në raportimin financiar në Shqipëri;
- Rritjen e kërkesës së publikut për publikimin e informacionit dhe transparencën e korporatës
- Uljen e rrezikut të mashtrimeve të konsiderueshme duke rritur ndërgjegjësimin për të drejtat dhe përgjegjësitë e njeriut; dhe
- Thellimin e njohurive lokale mbi raportimin financiar duke zgjeruar bazën e investuesve të mundshëm në Shqipëri.

Grupet Kryesore të Interesit

- Organi i Propozuar për Mbikqyrjen e Auditimit
- Ndërmarrje Tregtare
- IEKA
- Universitetet
- Qendra e Kuarikulave
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
- Komiteti për Zbatimin e Projektit (Komiteti Kombëtar Drejtues)
- Ministria e Financave

4.3.2 Aktiviteti 2: Trainime për Gjyqesorin dhe Ekspertët e Pavarur Financiare

Në vijim paraqiten rezultatet optimale të cilat duhet të arrihen nëpërmjet këtij dokumenti politikash dhe plan veprimi. Zbatimi me sukses i ketij veprimi specifik bazohet në këto supozime: Qeveria dhe grupet e interesit do të mbështesin zbatimin e këtij aktiviteti, palët e tjera do të japin mbështetjen e duhur, stafi ndihmës do te kete përvojen e nevojshme dhe të mjaftueshme dhe se mbështetja do te jete e qëndrueshme dhe e vazhdueshme deri në përfundimin e detyrës.

Objektivi

Një program trajnimi i hartuar dhe implementuar mire që do të rriste nivelin e gjyqtarëve dhe ekspertëve të pavarur financiarë, opinioni i të cilëve mund të ndikojë në vendimet e gjyqësorit, për të kuptuar rëndësinë e raportimit të mire financiar të korporatës dhe përgjegjësitë dhe të drejtat e palëve përkatëse.

Përshkrimi

Mbështetja e një programi trajnimi për t'u ardhur në ndihmë gjyqtarëve dhe ekspertëve të pavarur financiarë opinioni i të cilëve mund të ndikojë në vendimet e gjyqësorit në mënyrë që ata:

- Të japin në mënyrë të përmbledhur parimet dhe konvencionet bazë të raportimit financiar që janë themelore për të kuptuar llogaritë vjetore dhe të konsoliduara.
- Të përshkruajnë shkallën e vlerësimit dhe gjykimit që janë pjesë e pandarë në procesin e raportimit financiar.
- Të bëjnë dallimin midis llogarive vjetore dhe të konsoliduara të audituara dhe të paaudituara.
- Të marrin vendime të informuara në lidhje me vlerësimin e besueshmërisë së ekspertëve të vlerësimit të biznesit.
- Të bëjnë një përmbledhje të disa prej problemeve që dalin shpesh në proceset gjyqësore në lidhje me të dhënat financiare.

Ky trajnim do të përfshijë minimalisht:

- Llogari vjetore dhe të konsoliduara:
    - Përdorime dhe qëllime;
    - Objektiva;
    - Komponentë; dhe
    - Konventa/Marrëveshje dhe standarde;

- Parimet si baza për llogaritë vjetore dhe të konsoliduara:
    - Parimet bazë (SNRF, SKK);
    - Burim dhe hierarki; dhe
    - Vlerësim dhe gjykim.
- Llogari vjetore dhe të konsoliduara të audituara:
    - Objektivat dhe qëllimi i një auditimi;
    - Standardet e Auditimit (SNA);
    - Raporti i auditimit; dhe
    - Nivelet e kontrollit të cilësisë.
- Llojet e llogarive vjetore dhe të konsoliduara:
    - Shoqëritë/njësitë që përdorin llogari vjetore dhe të konsoliduara;
    - Llogaritë vjetore dhe të konsoliduara kundrejt raportimit rregullator; dhe
    - Nevojat e investuesve dhe të tjerëve.

Rezultati

Trajnimi dhe mbështetja për gjyqësorin dhe ekspertët e pavarur financiarë, opinioni i të cilëve mund të ndikojë në vendimet e gjyqësorit, në të kuptuarin e raportimit financiar të korporatave:

- Do të rrisin ndërgjegjësimin tek gjyqësori dhe ekspertët financiarë të pavarur, opinioni i të cilëve mund të ndikojë në vendimet e gjyqësorit, në lidhje me përfitimet dhe kërkesat e publikimeve dhe transparencën e korporatave në lidhje me raportimin e tyre financiar
- Do të rrisin kërkesën nga gjyqësori dhe ekspertë të pavarur financiarë, opinioni i të cilëve mund të ndikojë në vendimet e gjyqësorit, për publikime dhe transparencë të mirë të korporatave
- Do të shtojnë besimin e publikut në marrjen e masave ligjore, nqs ka pasur shkelje të rregullave;
- Do të rrisin kërkesën e publikut për publikim të informacionit (dhënien e shpjegimeve) dhe transparencë të korporatës; dhe
- Do të zvogëlojnë rrezikun e mashtrimeve të konsiderueshme duke rritur ndërgjegjësimin gjyqësor për të drejtat dhe përgjegjësitë e njeriut në lidhje me raportimin financiar të korporatës.

Grupet Kryesore të Interesit

- Gjyqësori
- Ekspertët e Pavarur Financiarë
- Komiteti për Zbatimin e Projektit (Komiteti Kombëtar Drejtues)
- Ministria e Financave

5 SHTYLLAT KRYESORE TË DOKUMENTIT TË POLITIKAVE DHE PLANIT TË VEPRIMIT

Komisoni Kombëtar Drejtues gjatë procesit të këshillimit përcaktoi shtyllat kryesore në të cilat do mbështet zbatimi i planit të veprimit të vendit.

Më poshtë (në figurë) ne kemi paraqitur shtyllat kryesore, të cilat përcaktojnë secilin prej veprimeve kryesore të identfikuar nga dokumenti i politikave dhe plani i veprimit të vendit.

Figura 5-1: Shtyllat e Përgjithshme Kryesore

SHTYLLAT KRYESORE PER IMPLEMENTIMIN E DOKUMENTIT TE POLITIKAVE DHE PLANIT TE VEPRIMIT NE SHQIPERI

Shtylla Kryesore 1: Përmirësimi i Kuadrit Institucional;

Shtylla Kryesore 2: Forcimi i Kapacitetit Institucional;

Shtylla Kryesore 3: Rritja e Ndërgjegjësimit mbi Raportimin Financiar dhe Auditimin Statutor.

Më poshtë në Figura 5-2: Përmirësimi i Kuadrit Institucional ne kemi parashtruar veprimet (aktivitetet) për tu marrë në konsideratë nën këtë shtyllë kryesore.

Figura 5-2: Përmirësimi i Kuadrit Institucional

SHTYLLA KRYESORE 1:

PËRMIRËSIMI I KUADRIT INSTITUCIONAL

- NJE KUADER STATUTOR I PLOTE, KONSISTENT DHE PRAKTIK
- KRIJIMI "QENDRA E KURRIKULAVE"
- KRIJIMI I ORGANIT MBIKQYRES TE AUDITIMIT
- KONSOLIDIMI I KESHILLIT KOMBETAR TE KONTABILITETIT

Më poshtë në Figura 5-3: Forcimi i Kapaciteteve Institucionale, ne kemi parashtruar veprimet për tu marrë në konsideratë nën këtë shtyllë kryesore.

Figura 5-3: Forcimi i Kapaciteteve Institucionale

SHTYLLA KRYESORE 2:

FORCIMI I KAPACITETIT INSTITUCIONAL

- BANKA QENDRORE: ZBATIMI I SNRF NE SEKTORIN BANKAR
- AUTORITETET E TATIMEVE: PERDORIMI I SKK DHE SNRF PER QELLIME TE TAKSAVE
- AUTORITETI I SHERBIMEVE FINANCIARE: ZBATIMI I SNRF NE SEKTORIN E SIGURIMEVE DHE TREGJET E KAPITALEVE
- QENDRA KOMBETARE E RREGJISTRIMIT: IMPLEMENTIMI I DEPOZITIMIT EFEKTIV NE FORME ELEKTRONIKE TE PASQYRAVE FINANCIARE
- PROFESIONI I AUDITUESIT
- PROFESIONI I KONTABILISTIT
- FORCIMI INSTITUCIONAL: SUPORT PER SEKTORIN E UNIVERSITETEVE

Më poshtë në Figura 5.4: Rritja e Ndërgjegjësimit për Raportimin Financiar të Korporatës dhe Auditimin, ne kemi paraqitur veprimet për tu marrë në konsideratë nën këtë shtyllë kryesore.

Figura 5-4: Rritja e Ndërgjegjësimit për Raportimin e Korporatës dhe Auditimin

SHTYLLA KRYESORE 3:

RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT MBI RAPORTIMIN FINANCIAR DHE AUDITIMIN STATUTOR.

- FUSHATE PER NDERGJEGJESIMIN E PUBLIKUT PER EKONOMINE INFORMALE DHE PERFITIMET E KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT
- TRAJNIM PER GJYQESORIN DHE EKSPERTET E PAVARUR FINACIARE

Kostot e dokumentit të politikave sipas shtyllave kryesore dhe Llojit të tyre **000 / Euro**

Kostot / *Veprimi*	*Operacionale*				*Teknike*				*Hardware / Software* *Pajisje*				*Kosto Totale 000/Euro*
	Totali	*Viti I-re*	*Viti II-re*	*Viti III-re*	*Totali*	*Viti I-re*	*Viti II-re*	*Viti III-re*	*Totali*	*Viti I-re*	*Viti II-re*	*Viti III-re*	
Shtylla Kryesore 1: Përmirësimi i Kuadrit Institucional:	805	268	268	269	1,512.5	505	505	502.5	110	110	0	0	2,427.5
Shtylla Kryesore 2: Forcimi i Kapaciteteve Institucionale:	375	125	125	125	2,575	858	858	859	300	300	0	0	3,250.0
Shtylla Kryesore 3: Rritja e Ndërgjegjësimit për Raportimin Financiar të Korporatës dhe Auditimin Statutor	400	133	133	134	0	0	0	0	0	0	0	0	400.0
Kosto Totale	1,580 €	526 €	526 €	528 €	4,087.5 €	1,363	1,363 €	1,361.5 €	410 €	410 €	0	0	6,077.5 €

6 PRIORITET E AKTIVITETEVE

Komiteti Kombëtar Drejtues ka shqyrtuar prioritet për zhvillimin e veprimeve sipas këtij plani veprimi gjithëpërfshirës.

Në mënyrë të qartë veprimi nr.1 ëahtë një prioritet pasi konsistenca dhe prakticiteti i legjislacionit ku bazohet kuadri i kontabilitetit dhe auditimit do të jetë themeli mbi të cilin do të mund të realizohen aktivitetet e tjera.

Për koordinimin e aktiviteteve të tjera do të ishte e arsyeshme të fillohej me përmirësimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (Veprimi 4) para se të fillojmë të mbështesim profesionin e kontabilitetit pasi puna kryesore për profesionin do të kryhet nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Megjathatë do të jetë e rendësishme për të mos lejuar qe të kalojë një kohë e gjatë para fillimit të aktivitetit 10 (mbështetje për profesionin).

Për sa i përket shtyllës kryesore të përgjithëshme më të rëndësishme do të ishte e arsyeshme ti jepej prioritet shtyllave të aktiviteteve "Përmirësimi i Kuadrit Institucional" dhe Forcimi i Kapaciteteve Institucionale", pasi përfundimi i këtyre aktiviteteve mund te lejojë një zhvillim më të butë të shtyllës së aktivitetit për "Rritjen e Ndërgjegjësimit të Raportimit Financiar të Korporatës dhe Auditimit".

Në përfundim, brenda shtyllës së aktivitetit për forcimin e kapaciteteve institucionale, mbështetja e organeve profesionale dhe universiteteve mund të kryhet e para meqënëse keto institucione primare të kontabilitetit dhe auditimit janë më afer pjesës kryesore të planit të aktivitetit.
KKD propozon që të kryhet një proces i vendosjes së prioriteve të aktiviteteve në mënyrë më të saktë, pasi të qartësohet disponibiliteti i fondeve.

7 GRAFIKU KOHOR PËR DOKUMENTIN E POLITIKAVE DHE PLANIN E VEPRIMIT

Gjatë përcaktimit të aktiviteteve që do të kryhen sipas dokumentit të politikave dhe planit të veprimit të vendit do të shqyrtohet dhe koha e kryerjes së tyre. Për të realizuar me sukses periudhën e implementimit pas pranimit të Planit të Veprimit, ne gjykojmë se duhet të përcaktohen korniza kohore të qarta. Për të arritur këtë objektiv Komiteti Kombëtar Drejtues ka përcaktuar datat kryesore (kyçe) për çdo veprim individual të shtyllave kryesore të aktiviteteve të planit.

Ky informacion ilustrohet më poshtë: Figura 6-1 Grafiku kohor për implementimin e dokumentit të dhe planit të veprimit

1. VEPRIM 1: NJE KUADER STATUTOR I PLOTE, KONSISTENT DHE PRAKTIK
2. VEPRIM 2: KRIJIMI I "QENDRES SE KURIKULES"
3. VEPRIM 3: KRIJIMI I ORGANIT MBIKQYRES TE AUDITIMIT
4. VEPRIM 4: KONSOLIDIMI I KESHILLIT KOMBETAR TE KONTABILITETIT
5. VEPRIM 5: BANKA QENDRORE: ZBATIMI I SNRF NE SEKTORIN BANKAR
6. VEPRIM 6: AUTORITETET E TATIMEVE: PERDORIMI I SKK DHE SNRF PER QELLIME TE TAKSAVE
7. VEPRIM 7: AUTORITETI I SHERBIMEVE FINANCIARE: ZBATIMI I SNRF NE SEKTORIN E SIGURIMEVE DHE TREGJET E KAPITALEVE
8. VEPRIM 8: QENDRA KOMBETARE E RREGJISTRIMIT: IMPLEMENTIMI I DEPOZITIMIT EFEKTIV NE FORME ELEKTRONIKE TE PASQYRAVE FINANCIARE
9. VEPRIM 9: PROFESIONI I AUDITUESIT
10. VEPRIM 10: PROFESIONI I KONTABILISTIT
11. VEPRIM 11: FORCIMI INSTITUCIONAL: SUPORT PER SEKTORIN E UNIVERSITETEVE
12. VEPRIM 12: FUSHATE PER NDERGJEGJESIMIN E PUBLIKUT PER EKONOMINE INFORMALE DHE PERFITIMET E KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT
13. VEPRIM 13: TRAJNIM PER GJYQESORIN DHE EKSPERTET E PAVARUR FINACIARE

8 IMPLEMENTIMI I PLANIFIKUAR I DOKUMENTIT TË POLITIKAVE DHE PLANIT TË VEPRIMIT

KKD ka shqyrtuar mënyrën e miratimit të dokumentit te politikave dhe planit të veprimit të vendit dhe rolin e vetë KKD në fazën e implementimit. Dokumenti i politikave dhe plani i veprimit të vendit do ti paraqiten zyrtarisht Ministrit të Financave dhe me tej ne Keshillin e Ministrave. Për implementimin e planit, në varësi të fondeve të mjaftueshme dhe miratimit të dokumenti i politikave dhe planit të veprimit, do të krijohet nje komision projekti.

Ky informacion ilustrohet më poshtë në **Figura 7-1: Miratimi & implementimi i dokumentit të politikave dhe planit të veprimit**

PREZANTIMI ZYRTAR I STRATEGJISE DHE PLANIT TE VEPRIMIT TE VENDIT MINISTRIT TE FINANCAVE

▼

PRANIMI I I STRATEGJISE DHE PLANIT TE VEPRIMIT TE VENDIT NGA MINISTRI I FINANCAVE

▼

KRIJIMI I NJESISE SE PROJEKTIT NGA MINISTRI I FINANCAVE

▼

NJESIA E IMPLEMENTIMIT DREJTUES TE PROJEKTIT ◄ ◄ KESHILLI KOMBETAR (KOMISION KESHILLIMOR PER NJESINE E PROJEKTIT DHE MINISTRIN E FINANCAVE)

▼

SHTYLLA KRYESORE 1: PËRMIRËSIMI I KUADRIT INSTITUCIONAL

- NJE KUADER STATUTOR I PLOTE, KONSISTENT DHE PRAKTIK
- KRIJIMI I "QENDRES SE KURIKULES"
- KRIJIMI I ORGANIT MBIKQYRES TE AUDITIMIT
- KONSOLIDIMI I KESHILLIT KOMBETAR TE KONTABILITETIT

SHTYLLA KRYESORE 2: FORCIMI I KAPACITETIT INSTITUCIONAL

- BANKA QENDRORE: ZBATIMI I SNRF NE SEKTORIN BANKAR
- AUTORITETET E TATIMEVE: PERDORIMI I SKK DHE SNRF PER QELLIME TE TAKSAVE
- AUTORITETI I SHERBIMEVE FINANCIARE: ZBATIMI I SNRF NE SEKTORIN E SIGURIMEVE DHE TREGJET E KAPITALEVE

- QENDRA KOMBETARE E RREGJISTRIMIT: IMPLEMENTIMI I DEPOZITIMIT EFEKTIV NE FORME ELEKTRONIKE TE PASQYRAVE FINANCIARE
- PROFESIONI I AUDITUESIT
- PROFESIONI I KONTABILISTIT
- FORCIMI INSTITUCIONAL: SUPORT PER SEKTORIN E UNIVERSITETEVE

SHTYLLA KRYESORE 3: RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT MBI RAPORTIMIN FINANCIAR DHE AUDITIMIN STATUTOR.

- FUSHATE PER NDERGJEGJESIMIN E PUBLIKUT PER EKONOMINE INFORMALE DHE PERFITIMET E KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT
- TRAJNIM PER GJYQESORIN DHE EKSPERTET E PAVARUR FINACIARE

Figura 6-1: Grafiku kohor për implementimin e dokumentit të dhe planit të veprimit.

ID	Detyrat	3M109	3M209	3M309	3M409	3M110	3M210	3M310	3M410	3M111	3M211	3M311	3M411
1	Nje kuader statutor i plote, konsistent dhe praktik												
2	Krijimi i "Qendres se kurikules												
3	Krijimi i organit Mbikqyres te Auditimit												
4	Konsolidimi i Keshillit kombetar te Kontabilitetit												
5	Banka qendrore: zbatimi i SNRF ne sektorin bankar												
6	Autoritetet e tatimeve: perdorimi i SKK dhe SNRF per qellime te taksave												
7	Autoriteti i sherbimeve financiare: zbatimi i SNRF ne sektorin e sigurimeve dhe tregjet e kapitaleve												
8	QKR implementimi i depozitimit efektiv ne forme elektronike te pasqyrave financiare												
9	profesioni i audituesit												
10	profesioni i kontabilistit												
11	Forcimi Institucional: per sektorin e universiteteve												
12	ndergjegjesimin e publikut per ekonomine informale dhe perfitimet e kontabilitetit dhe auditimit												
13	trajnim per gjyqesorin dhe ekspertet e pavarur finaciare												

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 5.8.2010
Doli nga shtypi më 7.8.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 76 lekë